


*Libra eshte e Gmver, Bendor
Cej i inokastre*

Ju Shqipëtar' me vllazën jini tuj vra,
En' nj qint çeta jini shpërda. V. P.

BARBARITE GREKE NE SHQIPERI


PREJ

COSTA P. TOMORI LEUSA



JOURNAL PRESS,
FRAMINGHAM, MASS.
1917.

KUSHTON 35c



Ju Shqipëtar' me vllazën jini tuj vra,
En' nj qint çeta jini shpërda. V. P.

BARBARITE GREKE NE SHQIPERI


PREJ

COSTA P. TOMORI LEUSA


JOURNAL PRESS
FRAMINGHAM, MASS.

1917

KUSHTON 35c



DELEGATIT TE SHQIPETAREVE T'AMERIKES
MEHMET BE KONITZA
QE PERPIQET T'A SHPETONJE SHQIPERINE
NGA MJERIME TE NESERME
SI ATO TE KESAJ LIBRE
KETE VEPRE JA DEDIKONJ
NJE USHTAR I TIJ.



Një shkrepëtimë, pastaj natë,
O e Bukur Fluturakë.

Parethenje

Të Dashur Këndonjës:

Atdheu tonë, Shqipërija e dashur, rojtur 500 vjet në tirani, nënë bajonetën e Turqisë. Flamuri tonë i nderçim, dhe madhështor i cili kur rontej Mbreti tonë Skender Beu dermoj heshtrat e Turqisë me 27 luftëra, më së fundi Turqia gjeti rastin ta groposnjë, pas vdekjes të ati mbret trim dhe kalorës i cili mbrojti nderin e Shqipërisë gjer orën e fundit.

Dhe kështu që më 1400 më 1913 Shqipërija rojti nënë zgjedhjen e Turqisë, e cila na ndroj të tëra zakonet tona. Na ndahu më dy part, Myslymanë dhe të Kërshterë, na futi më një armiqësi të madhe midis të Krështerëve dhe Myslymanëve. Myslymanët Shqipëtarë duke verbuar nga lavdija që ju dha Turqia, haruan atdhen'e tyre dhe punonin vetëm për nderin e Turqisë duke shtypur popullin i cili i dermuar dhe i shkelur nga këta tiranë, ushtrënguan të kërkojnë një mprojtje të cilën nuk'u kurzyhe ti ja japë Kleri Grek.

Kleri Grek duke përzjerë fenë me kombësi, gjeti një rast të mirë, për të pagëzuar për së dyti Shqipëtarët duke dhënë emërin Grek, se kështu ka thënë Zoti Krisht. (Që ç' do orthodhoks është Grekë!) Pushtuan pra të Krështerët me anën e kishave dhe të skollave.

Të Krështerët Shqipëtarë, duke gjendur nga njera anë nënë bajonetën e Turqisë, dhe nga ana tjetër si vëllezërit e tyre të djeshmit. Myslymanët Shqipëtarë duke nvarur pallën e Sulltan Murati në

qafë, po tregonëshin jo si Shqipëtarë, po si kur qenë vetë ata të ardhur prej Anadollit dhe zapëtuan Shqipërinë duke quajtur të Krështerët Shqipëtarë si robër. Kështu pra edhe të Krështerët Shqipëtarë, duke gjëndur në mes të këtyre dy zjareve pushtuan verbërisht rasën e klerit Grek, dhe ç'do fjalë që deltej nga gojë e tyre që e bërë ndër këta.

Ch'do njeri pra kur heth një farë në dhe vete me shpresë, që ajo farë dotë mbinjë, do të ritet, dhe kur të arihet do të shihonjë pemët e saj.

Kështu pra këtë farrë që mbuall prej 5 shekujsh mbi kuris të Shqipëtarëve, sot ardhni koha për të korrur. Farra azdis si kriza mbi kuris të Shqipëtarëve, dhe Shqipëtarët duke pandehur se kjo farë krisje një ditë doti nxirtej në lumtësi, po i shërbenin me ç'do farë mënyrë për të mos të humbur lumtësin' e tyre.

Më 1912 Shtetet e Ballkanit u bashkuan tok edhe deklaruan luftë kundra Turqisë, të cilën e dërmuan.

Në këtë luftë, Shqipëria u shkel, prej Greqisë, Serbisë, dhe Malit' Zi. Përveç Vlorës dhe Beratit të cilat nuk'u shkelë.

Të dyja Imperatoritë fqinjë të Shqipërisë Austria me Italinë duk me patur interesat e tyre, kur panë se më shuma tok'e Shqipërisë u shkel prej Shteteve Ballkanit. Nuk' u mënuan po thirë Ismail Qemalin dhe e këshilluan që të vinte në Vlorë dhe të deklaronte Independencën e Shqipërisë.

Ismail Qemali pas këshillës që i dhanë u ngrit dhe vate në Vlorë më 7të Vje. IIItë dhe deklaroi Independencën dhe ngriti Flamurin e Shqipërisë. Pastaj filloj dhe një Guvernë provizore që të Qeveriseshin ato vise të pa shkelura të Shqipë-

risë gjer sa t'i jepnin një funt çështjes Shqipëtare Fuqit'e mbëdha.

Kur u mbarua lufta Ballkanike, Fuqit'e mbëdha bënë një Konferencë në London për fatin e viseve që u shkelë prej shtetëve Ballkanit.

Djelmuriya Shqipëtare të merguar nga atdheu, në Amerikë, Misir, Vllahi, Bullgari e gjetkë, duke me rojtur në atmosferë të paqme u përmëntnë shumë shpejt nga gjymi i pa përmendur që i kish vënë propaganda e huaj. Kupëtuam se ç'do njeri në këtë botë që krijoi Zoti ju dha dhe nga një gjyhë, të cilën s'ka të drejtë njeri që ta ndallonjë. Kështu pra edhe neve si një Komp nga ata më të vjetërit në Ballkan duhet të rojmë të lirë, me gjyhën tonë të bukur ne atdhenë tonë të dashur, me zakonet tona të larta. Edhe për të fituar këto, djemt e Shqipërisë që ronin lark atdheut po përpiqeshin me gjithë fuqin'e tyre, me shoqëria, me protestime ndë fuqit'e mbëdha, me telegrame në konferencë të Londonit ku ju luteshin që të mos na hithnin më nonjë zgjedhje tjetër po të na jepnin lirinë tonë. Mundimet e gjithë Shqipëtarëve nacionalistë nuku ju vate kot se në këtë konferencë fuqit e mbëdha përfunduan që Shqipëria duhet të ronjë e lirë, nënëshkruan rojtjen e Shqipërisë si një shtet i ri në Ballkan me kufi që do të bisedoheshin prapë në këtë konferencë.

Gjithë kjo konferencë e cila vashdoj 5 muaj ndau kufirat e Shqipërisë të cilat janë këto, që nga Korça në mest të urave edhe deltej në anën e adriatikut në stillo. Përmblodhë këto qytete të Toskërisë. Korçën, Kolonjën, Leskovikun, Permetin Gino-kastrën, Delvinën, edhe Sarandën.

Për të ndarë vijat stratigjike, vendosnë që të dërgojnë një Komision internacional i cili me të mbaruar konferanca u nis për në Shqipëri. Guverna Greke kur mësoj që komisioni u nis për në Shqipëri për të ndarë viset zuri nga dhëlpëritë, dha urdher që trupat vulnetare që kish filuar me pahir të mer- nin armët edhe te sheshitnin në për rugat e qytetit duke kënduar këngë Gërqisht, ç'do njeri që sdintej Gërqisht të mos të deltej jashtë po të rinin mbyllur gjer sa të shkontej komisioni. Në për rugat, në për portat e shtëpine kishin vënë nga një tabellë Fren- qisht dhe Gërqisht ku thoshtej, bashkim me Gre- qinë ose vdekje. Po komisioni ardhi i pa të gjitha po s'u a vari torbën. Bënë urdherin që kishin, ndanë vijat, edhe shkuan.

Pastaj ardhi çeshtja e mbretit, cilin të dërgonin për fronin e shqipërisë. Dhëndurë për fronin e shqiperisë duall një duzinë, po fuqit' e mbëdha zgjo- dhë mbret për fronin e Shqipërisë prej oborit Gjer- man, Prince Vilhelm de Weid, Prinsesha Sofia, dhe trashëgjimtar' i fronit të cilën e quajtën Skender Be. Kështu pra mbret i Shqipërisë vuri Kurorën e Sken- der Beut, dhe u nis për në fron të Shqipërisë, që i u pregatit në Durës.

Gëzim që patnë Shqipëtarët e kulluar, nuku tregohet, bota ju dukej se qe e tyre, derthnin lot gasmore, dhe përhironin Zotin që i vlerësoj të shik- ojnë Shqipërin e lirë, me mbret dhe mbretëreshë, dhe flamurin i groposur prej 500 vjet të valontej ndë gjithë viset e Shqipërisë.

Po ky gas nuku mbajti shumë kohë, kjo liri na u duk si një ëndër e mirrë që e shikon njeriu natën, dhe kur zgjohet në mëngjes hidhërohet se i umbi të gjitha ato qe pa natën e shkuar dhe është ajy që qe

më parë. Kështu pra o të dashur këndonjës liri-
ja jonë na erdhi si ëndër dhe ëndër me përfundim
tragjik se Shqipëria në vënt që ti shionjë pemët'e
lirisë u bë kasapanë të fëmijës' saj! Ch'do barr,
ç'do lule, ç'do pyll, dhe ç'do mal u vaditnë me gjak,
prej grash, foshnja, dhe burra, që u masakruan prej
armikut e Shqipërisë, prej Grekërve barbarë. Këtë
librë që u jap sot Shqipëtareve, për shkruan mjeri-
met e Shqipërisë jugës, dhe shkakëtarët e këtyre
mjerimeve janë këta.

(1. Fuqit'e mbëdha që kriuan një shtet me
qëllim që të vdesë para se të lindet. Fuqit' e
mbëdha po të donin me të vërtetë që të rontej shteti
Shqipëtar do të bënë këto pllane. Shqipëtarët
(shumica e Shqipërisë) si një komp i pa ditur, si
një komp i ritur nënë bajonetën e Turqisë barbare,
si një komp i ritur me propaganda të huaja që punon-
in, dhe punojnë vetëm për botë, dhe nuku kanë ar-
irë në atë shkallë që të jenë dhe ata një komp si çdo
komp tjetër në këtë botë. Natyrisht po të lesh fatin
e një shteti ndër duart e këtyre që s'kanë njohur
edhe veten e tyre, do të ç'katërohet. Fuqit e mbëdha
pra duhej të dërgonin bashkë me organizatorët e
xhandërmarisë Shqipëtare dhe një ushtëri të vogël
internacionale që të mernin fren e qeverisë Shqipë-
tare për pak kohë gjer sa të regullonin pak shtetin.
Pastaj t'i dorëzonin fren e qeverisë mbretit Shqipë-
risë. Po fuqit'e mbëdha jo vetëm nuk i bënë
këto, po dhe ca prej tyre me anën e përfaqësonjësvet
që kishin dërguar në Shqipëri nuku lanë gjë pa për-
dorur që të përmbysin këtë shtet.

(2). Qeveria e Ismail Qemalit e cila në vënt
që të përkujdesej për organëzimin e një xhandar-
marije, ose një trupi ushtëriak për sigurimin e shte-

tit Shqipëtar, u muar me çështjen e kondicionëvet historike të bankës e të tramvejve.

(3). Tradhëtor' i Shqipërisë Esat Toptani, i cili kur se Shqipërija zurri të lulëzonte, ky efiat bëri një part kundra Shqipërisë dhe Mbretit. Dekllaroj luftë që të përmbysë Fronin e atdheut tij, të vriten vëlla me vëlla, edhe i të gjitha mjerimeve sa u bënë në Shqipëri.

(4). Shqipëtarëve të vetë quajtur nacionalistë, agallarë dhe bejlerë, të cilët, kur se u bë Shqipëria shtet me vete, nuku aruan zakon' e Turqisë punuan vetëm për xhepin e tyre edhe shitnë atdhenë për një vezë të kuqe.

(5). Shqipëtarët Grekomanë të Shqipërisë jugës, po unë në këtë libër flas vetëm për Grekërit dhe për Shqipëtarët Grekomanë, me anën e kësaj libër nuku desha të shtonj armiqësinë midis Shqipëtarëve dhe Grekërve, se këto mjerime do t'u duken si ëndëra, si përhalla o të dashur këndonjës, po janë të vërteta edhe më të shumta se sa kam shkruar, se fati tim më hodhi atje, dhe ti shikonj me syt'e mija!edhe jam dëshmor, në këtë botë, edhe në atë jetë përpara Zotit.

Shqiptarë, edhe juve djemtë tanë bres pas brezi kur të zini në gojë fjalën Grek mos harroni therjet, djegjet, dhe çnderimet.

Me nder,

KOSTA PAPPÀ TOMORI

Brockton, Mass, 1 Maj, 1917.

PROPAGANDAT TE USHTERISE GREKE NE SHQIPERI TE JUGES.

Shkuan 5 muaj që kur Ismail Qemali vate në Vlorë dhe deklaroi independencën të Shqipërisë, dhe ngriti Flamurin tonë kombëtar. Kjo ëndër që ushqenim na umbush; po s'na durohej pa parë dhe me sytë tona. Ky shkak pra na shtrëngoi bashkë me ca atdhetarë të lemë Amerikën dhe të vemi në Vlorë. Më 1 Gusht 1913 harrimë në Vlorë. Para se të shkellnin këmbët tona, dhen e atdheut tonë të dashur, ndjemë një mallëngjim. Vaporit qendroj dhe harriti kaikja që të na mertej, duallmë nga vaporit dhe rymë në kaikë, kaiken ezbukuruam me flamuret kombëtare që kishim me vehte, edhe pastaj morri udhën t'i afrohet skeles. Pa harritur në skele hodhëm sytë dhe pamë kestjellën e Vlorës, ku ish ngritur flamuri tonë kombëtar, edhe era e adriatikut po i jepte valja të ndryshme. Këtu sytë na u mbushnë me lot, se një zëh na tingëllontej ndër veshët t'ona me fjallët mirësarhtë djemt e mij në folenë tuaj. Në mes të këti anthisiazmi kënduam këngën Pranë Flamurit të Bashkuar. Duallmë në skele dhe u drejtuam për në kejtjellë për të vizituar Ismail Qemalë. Ismail Qemali na priti mirrë na pyeti nga vinim, dhe nga ç'vise të Shqipërisë qemë. I thamë vimë nga Amerika, edhe jemi nga Permeti dhe nga Korça, pas shumë fjalimesh Ismail Qemali na tha këto, që mos u dëshpëroni djem se për së shpejti dotë marrim lajmën gazmore që këto vise të Shqipërisë që gjenden sot nënë hien e armikut tonë do ti lenë nënë

hien e këti flamuri. Rroftë Shqipëria roftë Ismail Qemali thirëm. Pastaj u drejtuam për në qytet, vamë për të çlodhur me një nga hotelet e këti qyteti. Qeverija me gjithë qe qe me një pa regullim nuku ia dëshpëroj kur se Qeverisej prej Shqipëtarësh. Duke shpresuar që duke shkuar koha dhe duke vënë regulli që kështu të arrintej në atë shkallë që ëndëronim.

Pas katër dit ardhni lajma gasmore që Konferenca e Londonit i dha funt kufivet Shqipërisë, dhe Korça, Kolonja, Leskoviku, Permeti, Gjinokastrë, Tepelena, Delvina, Himarra dhe Saranda i mbetnë Shqipërisë dhe Greqia u zotua që këto vise dot'i dorëzonjë me regull dhe zyrtarisht ndër duar të xhandarmarisë Shqipëtare. Kjo lajme gëzoj gjithë zemrat e Shqipëtarëve, dhe atë mbrëma, bëmë përgatitje për një demonstracion. Gjithë qyteti u shukurua me Flamurë dhe me drita, gjithë populli u mbloth përpara gjykatores. Djemtë bënë një grup të veçantë, u vunë gjithë me sërë dhe ç'do djalë mbantej nga një qirri në dorrë. Të dy djemtë udhëheqës mbanin nga një Flamur në dorë. U nisnë djemtë përpara dhe prapa po u vinte populli. Sheshit më gjithë rugat e qytetit duke kënduar kënkë kombëtare. Qëndruam përpara Konsujve të Austrisë dhe të Italisë të cilët na mirëpritnë duke dalë në ballkon dhe duke thirrur roftë Shqipëria, dhe populli u përgjeq roftë Austria dhe Italia. Kështu mbaroj demonstracioni duke lënë një kujtim të pa arruar.

Zotimin që ju dha Greqia Fuqivet mbëdha na dha një kurajo që të lemë Vlorën dhe të vemi në Permet dhe atje të pritnim flamurin tonë dhe zyrtarët e Shqipërisë, po u gënjem!

Më 15 Gusht lamë Vlorën dhe u nismë për në

Permet, aritmë gjer në hani babajt. Këtu qiraxhiu na qëndroj dhe na tha, "ju lutem veshtroni mirrë se mos kini no një kartë Shqip ose Flamur se një çikë më poshtë është ushtëria Greke edhe çdo udhëtar që shkon ndër duar të atyre e qëndrojnë dhe e shikojnë, po ti gjejnë gjisendi e shpien në Kumandari në Këlcurë i cili e lith dhe e dërgon në Gjino-kastrë.

Kur dëgjyam këto fjalë vështruam njeri tjetër se këjo qe e para shigjetë që na çpoj zëmrën. U penduam që lamë Vlorën dhe rynim ndër duar të armikut për të vuajtur po qe von!...Inspektuam plaçkat tona dhe oqme ç'do gjë që munt të na hith-tej në rezik dhe kështu u nismë si Krishti që vate në Jerusalem me dashje për të vuajtur. Harimë të karakolli i cili na qëndroj, na pyeti ç'njerës qemë dhe nga vinim. Neve ju përgjeqmë që jemi të Krësh-terë nga Permeti, vimë nga Vlora, dhe vemi në Permet. Për fat të mirë gjetmë atje ca miq të cilët na shpëtuan dhe na lanë të lirë. Muarmë, rugën e Permeti që nga Klizura, gjer në Permet; u habit-më kurë pamë se me ç'do 5 minuta hudhë shinim tabella me këto shkrime Gerqisht dhe Frengjisht (Bashkim me Greqinë ose vdekje).

Harimë në Përmet. Të nesërmen na vjen një xhandarma në shtëpi dhe më dorëson një letrë ftimi nga an'e Qeveritarit Grek. Në orën që më ftonin vajta në gjykatore. Në gjykatore qenë zyrtarët Grek edhe Komisioni Grekoman i Përmetit të cilët qënë këta: veqil i Dhespotit Z. Spiridhon, Vasil Stefan, Koço Bibi, edhe Qako Gerxhe. Hyra brënda u dhashë vaftin, dhe ndënja. Mer fjalën qeveritari dhe i thotë kryedivizionit Z. Mallama, ja na ardhni dhe një mik i ri. Z. Mallama u egërsua dhe më thotë,

—nga je?—Nga Lausa, ju përgjegja—Ku ke qënë?
 në Amerikë.—Kur ardhe, dhe nga ç'anë? Nga Vlora
 —Duket që je dhe ti nga Turko Allbanonjtë.—Jo
 jam i Krështerë.—Po ç'diall propagandë u heq si
 magnit edhe punoni kundër neve që u kemi hapur
 sytë?—Kemi punuar që në kohë të Turqisë i thashë.
 —Po tani ç'djall kërkoni? —S'kërkojmë gjisendi,
 ju përgjegja.—Qysh më thua s'kërkoni gjisendi?
 —Ch'janë këto? më nzori ca numura të gazetës
 Djelli, kur qenë botuar Protestimet dhe telegramet
 që u dërguan nga Shqipëtarët e Amerikës për në
 Konferencë të Londonit. Pastaj me nzjer një listë
 me emërat e më të shumëve Shqipëtarë të Amerikës
 edhe më pyet. —Nga këto emëra që janë këtu, a nje
 nonjë? —Njoh shumë prej ta, ju përgjegja.—Po
 tani ku gjenden këta njerës? —Në Amerikë i lashë
 ju përgjegja. —Jo, neve kemi lajme që shumë prej
 këta janë këttu rotull çeta bashkë me Turko-Allva-
 nus. —Nuku di gjë nga këto i thashë, unë në Ame-
 rikë i lashë. Pastaj mer fjalën Qeveritari dhe thotë:
 Këtyre duhet tu a ndjejmë për sa që kanë punuar se
 tani e tutje do të binden te Qeverija tonë. —Do të
 hiqni dorë nga kjo idhe? më thotë Mallama.—Po,
 i thashë. Chap në shtëpi më tha po vështro mirë mos
 bëni mbi udhë e nënë udhë. Dolla nga gjykatorja
 dhe vajta në shtëpi.

Të nesërmen vjn kafaz i Mitropolisë dhe më
 dorëzon një letrë. E hap dhe leçit këto.

Zoti Costa Pappa:—

Pas vendimit të kryetarit edhe të Pleqve (tis
 ethniqis aminis) mbrojtja naticionale!... nesër
 në orën 2. P. D. të urdhëroni në Mitropoli për një
 çështje me rëndësi. Kryetari Konom Spiridhon

Permet 14 Gusht 1913

Pas urdhërit letrës u drejtova për në Mitropoli. Në dhomën e Mitropolisë gjeta kryetarë me gjithë pleqtë (tis ethniqis amina) u dhashë vaftin dhe ndenja. Pas pak minuta mer fjalën kryetari dhe më thotë: Zoti Pappa e muart një letrë që u çuam dihe me kafazin e mitropolise? "E mora, prandaj ardha." u përgjegja. Shkaku i thirjes tuaj këtu është kjo:

(I ethniqi amina) ka dyshim tek ty se je shqipëtar se në Amerikë s'kini lënë gjë pa përdorur për të dhënë atdhenë ndër duart e Turqise!.....

A do të ini të bindur ndë këto që përfunduam? Ch' përfunduat ju përgjegja?

(I ethniqi amina) kërkon ngaty (një grapton orkon) be të shkruar që dotë eqish dorë nga kjo idhe që ke patur. Jam i bindur që kurse ardha këtu ju përgjegja me tregon ben' eshkruar ku thoshtej kështu.

Unë i nënëshkruari betohem mi emërin e Krishtit përpara (tis ethniqis amina) që sot pendohem, dhe heq dorë nga idhea që kam patur, dhe do te jem besnik (istin mitera e ladha) pas si e lëçita më thotë kryetari jini të bindur? dashur pa uashur jam i thashë. Athere u ngrini të gjithë më këmbë. Kryetari e leçiti me zë të lartë edhe une dorën edjatht e mbanja mi Ungijll, dhe kur mbaroj nënëshkuova. Keshtuë pra dolla i lire nga mitropolia.

Më 16, Gusht 1913, mitropolia ndau ç'a zëdhënjë ku ftonte gjithë djemtë dhe burat te vërsëj 18-45, dita e mbledhjes qe dita e Diel, në shesh të mitropolisë gjithë kështu bënë dhe në viset e tjera që kish zaptuar ushtëria Greke. Pas urdhërit mitropolisë ditën e Diel u mblodhë gjithë në sheshin e mitropolisë. Suma kapërzhentej nga 800 Shpirt.

(i ethniqi amina) gjendej me një dëshpërim të math. Zun'e mblidheshin në mitropoli dit'e natë e mentoheshin ç'rugë të zinin. Përndanë më ç'do fshat bashkë me 6 kolla kartë të mbëdha, çdo kollë kartë shkruantej përsipër Gërqisht dhe Frenqisht (Lunion ou la mort) bashkim ose vdekje. Në këto 6 kolla kartë duhej të shkruanin emërat e të gjithëve sa gjendeshin atje dhe ata që gjendeshin në mergjim dhe kur ki mbaronin ti dërgonin prapë në mitropoli. Si i mblodhi këto mitropolia i dërgoj me të 6 Fuqit e mbëdha si dokument që vendi nuku aksepton vendimin e tyre dhe jan gati që të vdesin.

Më 15 të vjeshtës 1 u dhanë urdhër gjithë fshatërave që të diel më 16 të këti muaj të vinin të gjithë në Permet burat me armë, gra djem dhe gjithë priftërinjtë. Gjith ky urdhër udha edhe në Gjino-kastrë, Delvinë, Tepelenë dhe Leskoviç. Dit e Diel ardhi dhe njerëzia si mizat po mblidheshin në shesh të mitropolisë. Numur'i njerëzise kapërzentej nga të dy mijat, oficerët vunë vulnetarët të gjithë me serë pas pak minuta duall nga mitropolia (i ethniqi amina) dhe gjithë priftërija. Priftërija hynë në Kishë dhe u veshnë me petkat e shënjta, duall jashtë dhe kryetar'i (ethniqis amina) dha urdhër që të drejtoheshim për në vend të shënuar i cili qe një shesh i math jashtë qytetit.

Pas urdhërit të gjithë me regull u nisnë për në vend të shënuar. Harinë te vendi, atje ushtëria Greke kish rethuar tërë sheshin në mes të sheshit qe një tryezë mbuluar me flamurin e Greqisë. Mbi tryezë që Ungjilli shënjtë. Mesonjësit kishin radhitur djemt'e shkollës me nga një flamur të Greqisë në dorë. Gjithë kështu dhe mesonjëset kishin sjellë çupat e shkollës të mveshura me nga një blluzë të

Pas pak minuta dual nga mitropolia (iethniqi amina) Kryepoliça dhe Kryedivizioni i ushtërisë Greke Z. Malama.

Del përpara Z. Malama dhe thote këto:

Djem (tis miteras elladhos) një gas të math ndjenj kur shikonj se vrapuat të gjithë në thirjen tonë. Qëllim'i i thirjes është ky.

“Me hidrim të math dot'u lajmëronj që fuqit' e mbëdha kanë ndër mënt që tu ndajnë nga gjiri (tis mitros elladhoj), dhe do tu japin ndër duar të barbarë-shqipëtarë, ku do t'u prishin fenë dot' u çnderojnë dhe dotë vuani me keq se në kohën e tiranisë turke, prandaj sot u thirëm që tu organizojmë për luftën e nesërme. Dot'u japim pra të gjithëve armë, dhe do të bëni gjimnastike tri herë në javë. Kështu pra të ini të gatitëshme për ditën e nesërme që të ini të zotë tu bëni ballë barbarëve Shqipëtarë, kur neve do të jemi të shtrënguar ta zbrazim këtë vent. Besimin e kemi të plotë në ndjenjat tuaj patriotike. Mos u dëshpëroni pra se neve nuku do tu lemë vetëm do të dalim nga porta, dhe do të ryjmë nga deriçka, do të jemi kurdoherë në kraun e djath-të tuaj.” Pas fjalët këtij folë dhe të tjerë; pasi mbaruan fjalët zunë duartrokitje të pareshtura duke thirur. (enosis i thanatos) “bashkim ose vdekje.” Pastaj të gjithë siç qenë u drejtuan për ne policianë dhe të gjithë me radhë shkruheshin dhe mernin nga një dyfek me 50 fishekë. Si muar armët u përndanë në për shtëpira. Kur vintej ora e gjimnastikës binin kambanat dhe të gjithë mblidheshin më një shesh jashtë qytetit, dhe bashkë me ushtërinë Greke ushtëroheshin 4 orë ditën.


Më 1 të vjeshtës parë muar lajmen zyrtarisht, që këto vise Konferenca e Londonit ja la Shqipërisë.

kalter dhe nga një çapar të shkruar në gjokës me shkrime të arta bashkim ose vdekje. Pranë tryezës qendoronte veqil mitropoliti me gjithë priftërinjtë dhe (i ethniqi amina). Pas pak aritnë dhe zyrtarët e Qeverisë Greke.

Zuri Dhoxollogia për mbretin'e Greqisë. Ushtëria e regullshme bashkë me vulnetarët qindronin për nder arm. Pasi mbaruan Dhoxollogjinë veqil mitropoliti nisi një fjalë të gjatë. Po unë këndonjësve do t'u them vetëm kupëtimin e fjalës. Vëllezër tha, sot çfaq hidhrimin tonë, se fuqit'e mbëdha Evropa e qytetëruar na dënojnë neve që jemi fjesht Grekër!... dhe na japin ndër duar të barbarëve Shqipëtarë! Ndë qoftë pra se neve unjim kryet tona ndër ata ta dini që feja tonë do të na priset, gratë dhe motrat tona do të na ç'nderohen, dhe do të jemi robër për jetë! Fundi i fundit a do ti akseptojmë të gjitha këto të këqija? jo them kurrë, se gjaku tonë grek! po lëviz në për rembat tona dhe cili do prej nesh do të vdesë me pushkë në dorë dhe kurrë nuku do ta akseptojmë që të hyjnë barbarët Shqipëtarë në atdhenë tonë Greke!"... Të gjithë bërtitnë, "Jo, kurrë, duam bashkim ose vdekje!"

Atere sot në këtë protestim të sotme duhet të betohemi mbi Ungjillin e shëntjës, që do të derdhim dhe pikën e gjakut të fundit dhe në duart e Shqipëtarëve nuku do të jepemi dhe në qoftë se nuku'i bëjmë ballë kësaj gjemë ahëre dot'u vemë zjarë shtëpivet tona që kështu Shqipëtarët të gjejnë vetëm gërmadha. Të gjithë bërtasin do ti djegjim. Veqil mitropoliti thiri do të betohemi? Të gjithë u përgjegjë, betohemi. Që të gjithë u betuhan.

Pastaj morri fjalën qeveritari Grek, dhe përhiron gjindjen për ndjenjat Greke, dhe u thotë, "Që



Ministri i Ushtrisë Epirit Z. Dhulli Bashkë me misionë e mbrojtjes
dhe Kumandar i trupave Vulnetar të Përmetit Papa Gjorgjiu.


si do që të jetë (i mitera Elas) nuku do t'i lerë vetëm, po do tu jetë gjithënjë pas. Me të mbaruar fjalën Qeveritari, populli u përnda. (ethniqi amina) u drejtuan për në telegrafanë ku telegrafisnë me të gjashtë fuqit'e mbëdha dëshirën e popullit që duan bashkim me Greqinë ose vdekje, dhe një tjetër telegram Mbretit Greqisë Konstandinit, që të mos ti lerë ndër duar të Shqipëtarëve.

Shkuan tre muaj që po përpiqeshin të mjerët me protestime, me telegrame, me Delegatë në London, po më kot. Vendi është i Shqipërisë. Fuqit'e mbëdha i dhanë notën Greqisë që të zbrazë vendin e Shqipërisë dhe ta dorëzonjë zyrtarisht në organizatorët e xhandërmarisë Shqipëtare të cilët u urdhëruan Ollandhezët.

Qëllimin që të bënin kryengritje e kishin Grekomanët, dhe gjithënjë po bënin mbledhje për planin e kryengritjes, po qeveria greke sa po mori notën e fuqive mbëdha e bëri të njohur këtë notë në (ethniqi amina) që pas urdhërit fuqive mbëdha shtrëngohem që ta zbraz vendin me regul, dhe tu a dorëzonj zyrtarisht. Përandaj juve do mos deklaroni dot kryengritjen gjersa ushtëria tonë është brënda; se po ta bëni tani, do të na bjerë nderi. Sa po që neve ta eqim ushtërinë, dota çpallni kryengritjen pas programit që do t'ju japim. Për të holla, për ushtëri, dhe për municione mos kini qeder se kemi neve.

Grekomanët u dëshpëruan pak se kishin ndër mënt ta deklaronin kryengritjen pa ikur ushtëria Greke.

Pas tri dit që kur se qeveria Greke ju tha këto grekomanëve, bashkë me qeverinë Greqe e ndryshuan këtë vendim, dhe vendosnë që të mbanin një



mbledhje në Gjinokastrë.

Dita e mbledhjes qe më 27 Jenarit dit'e Diel. Dhespoti Konices qe kryetar'i mbledhjes; në këtë mbledhje dërguan delegatë këto qytete: Preveza, Ianina, Konica, Paramithia, Voshtina, Leskoviku, Kolonja, Korça Permeti, Tepelena, Gjinokastrë, Himara, dhe Delvina, Permeti dërgoj këta delegatë; veqil Mitropolitin, Vasil Stefan, Iosif Bensa, Lambro Donato, Qako Gerxhe. Kjo mbledhje mbajti dy javë Më 10 të shkurtit u këthyen nga Gjinokastrë Veqil mitropolitin dhe Vasil Stefani dhe përhapnë vendimin e mbledhjes që kryengritja dotë deklarohet këto dit.

Më 4 të Shkurtit, qeveria greke dorëzoi zyrtarisht Korçën dhe Frashërin, pastaj Kolonjën dhe me 10 të këti muaj dotë dorëzonte dhe Permetin. Kur ardhi ushtëria Greke nga Frashëri një zi e madhe mbuloj qytetin, këmbanat po tingëllonin për vdekje! Friftëria po jepnin emernin duke kallur frikë popullit që Shqipëtarët do të na prishin fenë. Pastaj hapnë një tjetër lajme që Shqipëtarët kur hynë në Frashër vanë në kishë dhe thyhen gjithë korat e kishës. Kur digjoj populli këtë lajme u egërsuan më keq dhe zun'e thrisnin kundër Konstandinit dhe Venizelos që i shiti ndër Shqipëtarët! Më 6 të shkurtit mitropolia ndau ca zëdhënje në gjithë fshatërat ku u thoshte këto: Sonte të mblidhi të gjithë në kishë dhe të bëni (Panihidhe) të fali të tërë natën dhe në mengjes të kungoni për herën e fundit!...se ardhi fundja tonë dhe e fesë. Kështu pra që të gjithë u mblodhë në për kishët e tyre dhe kunguan!....

Të shtunë mbrëma vjen një telegram nga Zo-grafua ku urdhërontej Permetin që të Diel në mëngjes të deklaronin kryengritjen, dhe i këshëllonte

që të mos dëshpërohen se do ta fitojnë. Kur mësuan këtë lajme një gaz i math mbuloj popullin dhe ushërinë Greke oficerët po pinin në për kafeanët dhe thrisnin (Zito i epanastasis). Të Diel pas kishe vendosnë që të deklaropin kryengritjen. U muar vesh me guvernën Greke dhe u dhanë zëh gjithë fshatërave që të Diel në mengjes të vinin me armë në Përmet.



DEKLARATA E KRYENGRITJES

Mbledhja e Ipirotëve që u mbajt në Gjinokastrë, nën kryesinë e Dhespotit Konices, që përfundoj Kryengritjen, zgjodhi një guvernë provizore; Kryetar, Kristaq Zografon, dhe ministrinë luftës Z. Dhuli. Z. Dhuli që një oficer Grek, i cili gjoja nuku digjoj këshilat e guvernës ti po u bë kaçak, dhe u bashkua me Zografon. Kryeqytet bënë Gjinokastrën, arkë Athinën dhe municionet vinin nga Fjorgoçati e cila që qendra e ushtërisë Greke.

Zografua është Shqipëtar i lindur në Qesarat të Gjinokastrës, është shumë i pasur dhe ditën që e zgjodhë Kryetarin e guvernës Autonome, Zografua dhuroj (dhia ton agona) tridhjet'e dy mijë lira. Të lumtë or tradhëtor! Grekun që e do shumë ky kafshë shkaku është ky: Greku si dinak i ka krehur bishtin, i ka dhënë punëra në qeveri të Athinës, dhe me këto dinakëri e bënë Zografon fjesht Grek. Zografua kur ardhë koha që Shqipëria mëma etij dërmoj zinxhirat e tiranie prej pesëqint vjet robërje, hapi krahët e saj të lira që të pushtontej fëmijën e saj, po u gënjeve e mjera Shqipëri! se këta djem që u ritnë nga gjiri yt tu bënë si alë në syt. Këta djem muar zinxhirat me të forta nga të parat, që të të lithnin për jetë. Po pse mor Zografo u bërë tradhëtor i mëmës tënde dhe nxive emërin t'ent në historinë e Shqipërisë? që djemt e Shqipërisë kur do të zënë emërin t'ent në gojë do të dridhen dhe do të të mallkojnë me fjalë më të poshtëra që janë në botë.

Të Shtunën mbrëma ardhë nga Gjinokastrë në Përmet një oficer Grek i quajtur Joanidhi, mveshur

me petka politike. Sa po ardhi mblodhi (tin ethniqin amina) dhe u shtroj programin e kryengritjes. Më orën 8. p. d. u nis nga Përmeti me ca ushtarë Grekër dhe vate mblodhi djemt'e këtyre fshatërave: Malëshovë, Brezhan, Argova, dhe Buhal. Të gjithë këta djem me armë të Diel në mëngjes rethuan Përmetin me flamurin e Autonomisë e cila kish ngjyrë të kaltër me një shqiponjë me dy krerë, dhe e ngritnë në Bolëngë. Bolënga është si kala mbi Përmet.

Atë mëngjes njerëzia po mblidheshin në kishë të Mitropolisë që quhet Shën Kolli. Të gjithë ata që qenë me armë, rethuan kishën; në kishë mbrënda hynë ata që s'kishin armë, priftërinj gra pleq djem dhe vajëza. Priftërinjtë u mveshnë me petkat e shënjta, dhe zunë lavderimin për mbren e Greqisë. Si u mbarua lavdërimi, Veqil mitropolit, del në der'e bukur me një kryq në dorë, dhe thote, "Vëllezër mbledhje e sotme këtu në kishë është mbledhje vajtimi. Këtë kryq të cilën kemi kaqë shekuj që po e mprojmë sot me dashjen e fuqive të mbëdha po na e hedhin poshtë, po na e ç'nderojnë duke dhënë nder duart e Shqipëtarëve barbare!

Në këtë mbledhje të vajtishim dua ty pyes për herën e fundit, cilën nga të dyja dotë zgjithni, vdekjen apo rojtjen? të gjithë thirë rojtjen! ahëre në duam të rojmë me nder, në duam që të mos ç'nderohen fëmija jonë, në duam që këtë kryq që e kemi mbajtur gjer më sot me nder, dhe i cili na ka shpëtuar nga shumë rëzike nga duart'e Turkut, dhe të cilën do ta kemi mbrojtës kur do herë, duhet të marim armët ndër duar, dhe të mos të jepemi ndër duart e barbarëve!...

Mos u dëshpëroni se Krishti është me ne. Të gjithë thirë, dotë vdesim me armë ndër duar dhe

nder Shqipëtarët nuku jepemi.”

Ahere sot është dit'e Kryengritjes, sot deklaromë Autonomin'e viseve që u gjykuan nga fuqit'e pa mëshirëshmet dhe ja dhanë Shqipërisë!.....

Roftë flamur'i Autonomisë!

Dhe nzori flamurin e Autonomisë që e kishin ngreur në tribunë të shënjtë.

Të gjithë thirë, “roftë!”

Veqil mitropoliti qe nga viset e Shqipërisë nga fshati Hlomo kaza Gjinokastrë.

Sa veqil'i besës, sa veqil i Krishtit, ashtu të thotë Krishti or judhe? mer Kryqin dhe deklaro kryengritje brënda në Kishë! vrasje, therje, ç'nderime grash, e mijëra të liga të tjera. Mjerë popull'i paditur që i iqni si arinë me allkë ndër undë, dhe se kanë kupëtuar edhe që tua rëmbenjë atë kryq që mbani në dorë dhe tu athyenj pas kokë, se atë kryq që mbani ju, nuku është i Krishtit po i shejtanit. Gjer kur or popull i ngratë do të përmendi nga ky gjymë i thellë? dhe të shpetoni nga këta korba që u kanë ipnotisur, dhe zdini seç bëni, dhe ju benë vegla për të mbaruar dëshirat e tyre djallëzore.

Pa mejtouni, për cilin'i muart ato armë ndër duar? Kundër kujt? Kundra mëmës tuaj, kundra atdheut dashur, kundra Shqipërisë!.. Zgjojuni sa më shpejt, pendojuni për vrasjen e mëmës tuaj, se ini yu shkakëtarët; pendojuni se mallëkim'i mëmës tuaj do tu zërë. Buza tuaj nuku do tu qeshnjë, ndërgjegja tuaj nuku do tu lerë të qetë hija e mëmës tuaj do tu ç'faqet kur do herë kudo që të ini, nga do që të vini e ç'veshur, me lot ndër sy, dhe do tu thotë përse ju djemt e mi me katandistë në këtë shkallë? Nuku jam nënja tuaj? ajdeni prapë në gjir'im, se jam nënja tuaj, ini djemt e mi prapë u

dua me dhimbet për ju se u kam ritur.

Cila zemër do të jetë ajo kur do të mësonjë ngjarjet e Shqipërisë dhe shkakëtarët e mjerimeve të jenë vetë Shqipëtarët e të mos copëtohet? Besonj që dhe armiqtë tanë do të derdhnin no një lot meshirë.

A, or fat ynë! A o Zot! kur e dinje që neve Shqipëtarët do ta nzinim historinë përse të na nzi-
nje fare në botë? e nuku na linje në herësirën Plutoniane.....

Fas si mbaroj fjalën veqil dhespoti muar fjalën këta zotërinj: Llambro Dhonato, Pappa Vasil, Vasil Dhaskali, Mihallaq Kriqe. Subjekti i tyre që gjithë ay Veqil Mitropolitit. Me të mbaruar fjalët, të gjithë duall jashtë, me flamurin e Autonomisë.

Qeveria Greke e cila e dintej seç do të ngjistej, kish dërguar policien, me ushtarë të regullshme sfungjitarë, dhe kishin zënë portat e kishës, që të mos ti linin gjoja të dilnin Kryengritësit.

Kryengritësit pasi u vunë me radhë nga katër e nga katër, në krye qindroj veqil mitropolitit, dhe u sulë që të dilnin jashtë nga porta. Polica Grek ju thotë, qindroni. Ata qindruan, polica pyet veqilë ku vini? Veqili ju përgjeq, puna tonë është se ku vemi. Polica u thotë, kemi urdhër nga qeveria e Athinës që të mos të bëni no një lëvizje të tillë, po të përndahi. Veqili kthehet nga populli dhe u thotë, vëllezër polica na urdhëron që të përndahemi, ju ç'thoni? Të gjithë me një zë thirë, vdesim këtu dhe nuku përndahemi, po përpara! përpara! Zun'e po shtytnin njeri tjetër polica me ushtarët dhe me qeveritarë po mundoheshin të varfërit që ti ndallo-
nin po nuku muntne! se kryengritësit u dhanë nga një të shtymë dhe i hodhë mu në vijë ku shkontej

ujët. Unë që ndodhesha atje më ardhi keq se u vranë të mjerët!.....

Po or dinakë me këto djallëzi doni ti mbuloni dinakëritë tuaj? a mbulonen kurrë qiejtë më plaf? Kurrë! Ju po të donit me të vërtetë ta ndallonit kryengritjen jo me sfungji të vinit po me nga një shufre në dorë. Popull'i mjerë nukë tundej nga vendi, po ju i ngrit or barbare, ju me pahir.

Kështu pra kryengritësit duall faqë bardhë se poshtëruan qeverinë Greke. Zyrtarët e qeverisë Greke si e panë pisk, nga kryengritësit u përndanë. Kryengritësit duall jashtë u mblodhë dhe të tjerët që kishin rethuar qytetin u bashkuan të gjithë tok, dhe zunë të sheshitnin rugat e qytetit duke kënduar këngë Gërqisht (mavr'i nikta sta vuna!) dhe duke thirur poshtë Shqipëria.....

Grekërit i shikonin këto gjëra për së largu dhe u gëzonte shpirti, se u vunë frenë kafsheve dhe po i lonin si të donin.

Pa si mbaruan së sheshituri u mblodhë prapë në mitropoli dhe ngrinë flamurin e Autonomisë, se në gjykatore ishte zyrtarisht flamuri Gërqisë, dhe nuk'ju heptej dorë Grekëve që ta ngrenin në gjykatore, se ahëre dukej faqeza bashkim'i Gërqisë me kryengritësit.

Me të mbaruar kjo komedi, veqil mitropoliti ju tha kryengritësve që të përndahen dhe me të nesërmen të mblidheshin prapë në mitropoli. Si u përndanë kryengritësit u mblodhë në mitropoli (ethniqi amina) në këtë mblodhje mori pjesë dhe qeveritari Grek Z. Dasho. Qillimi i kësaj mblodhje që për të zgjedhur një guvernë Autonome dhe u zgjodhë këta: Qeveritar veqil Dhespoti! sekretar Dhamë Prtheni, arkëtar, Qako Gerxhe, police, Mi-

halaq Kriqe, sekretar i policës Illi Apostolli, gjithë kështu u zgjodhë dhe kujdestarë të ngrënjeve këta: Kryetar Mantno Nana, sekretar, Lipe Hristidhi; ndihmës, Dhjonis Jani dhe Ngeli Sofroni. Gjithë kështu u zgjodhë dhe nga viset e tjera, Gjinokastrë, Delvinë, Tepelenë, dhe Leskovik, se Korça ato dit u dha zyrtarisht ndër Shqipëtarët dhe nuku aritnë të bënin Kryengritjen. Kryetarët e ushtërive më të gjitha viset qënë këta:

Gjinokastre.....Kolloneli Grek Dhuli
Delvinë.....Oficeri Grek Joanidhi
Përmet.....Kolloneli Grek Mavroidhi
Tepelenë.....Kolloneli Grek Zirra
Leskovik.....Kolloneli Grek Leondokanaki

Të Diel mbrëme 15 Shkurt 1914 ardhni një telegram nga Janina guvernës Autonome ku ju thoshtej që të Hënen të pritni 500 ushtarë Grekër (lipotakte) me 10 oficerë.

Të Hënen pas urdherit veqilit gjithë kryengritësit u mblodhë në mitropoli. Polica i regjistroj të gjithë me radhë në Protokoll si mbaroj se regjistruar doli veqili qindroj në mes të kryengritësve dhe u thotë; zer'i atdheut (i mitir Ellas) u thiri dhe ju s'vonnat në thirjen e saj, po rëmbyhet armët dhe u mblothtë reth flamurit.

Po u kishillonj që të mos dëshpëroji se s'jemi vetëm, nënën tonë Elladhën e kemi në kra të djathtë, dua të jini trima të pa trëmbur, dhe të mproni atdhenë nga çdo rëzik që ti vinjë, që sot e tutje të jini të bindur në oficerët tuaj të cilët dotë na vinë sot.

Pas këtyre fjalëve ju thotë: "Tani pregatituni të dalim jashtë qytetit të presim vulnetarët duhet t' i nderojmë se këta po bëhen thërorë për vendin tone." U radhosnë të gjithë dhe duall jashtë në për

rugat Kendonin këngë Gërqiisht; si duall jashtë qytetit qindruan dhe ndënjë gjër sa të vinin vulnetarët.

Pas një orë aritnë vulnetarët. Kur u afruan afër u ndreqnë të githë me radhë, pas urdherit veqilit dhe zunë të kendonin marshin e Elladhës. Si mbaruan marshin Mihallaq Kriqe thiri (Zito ta palikaria t'u paneliniu) pastaj mori fjalën veqili ku ju tha miresardhjen. Pas fjalës veqilit mori fjalën Kocifaqi oficeri Grek që ardhë me vulnetarët, i cili tha që mos u trempni se nuku do tu lëmë të vuani, dotë derdhim dhe piken e gjakut të fundit dhe nuku do t'u lëmë të bini ndër duart të barbarëve! Duartrokkitje buxhitnë, me fjalët rofte mbreti ynë Kostandini.

U gëzuat or kafshë që ju ardhë vëllezërit për ndihmë, se keta u shkretuan shtëpitë tuaj, këta u ç'nderuan gratë, këta ju therë femijën tuaj, keta ju bënë të githë të ligat që janë në botë. Besonj që tani dote jini penduar po eshte von!

Ketu do tu them çilët qenë këta vulnetarë. Oficeri Grek, Jani Koçifaqi nga Narta, Psaroj, një katil nga viset'e tjra të Greqisë. Oficerët të mveshur me petkat e Qeverisë vetëm nga shapka kishin hequr koronën, petkat e ushtarëve qenë gjithë të qeverisë dhe në kokë kishin lidhur nga një shami të zezë. U radhosnë të githë dhe u nisnë për në mitropoli. Polica u përkujdes për vënd që të çlodheshin vulnetarët, i përndau të gjithë në për shtëpira nga 4 nga 5 ju ndanë dhe të ngrëna. Atë ditë vjën një telegram nga Dhespoti Koniçës ku thoshtej që pritni 1500 shpirt. Këta ardhë në Gjinokastrë dhe u përndanë kesisoj.

500 qint Shpirt Gjiritllinj vanë në Leskoviç në kryesin e kapedan Fiorgagaqit gjith nga Gjiriti, 500 ardhë në Përmet në kryesin' e një prifti katil nga Suli i quajtur Papa Jani, dhe dy kapedanë të tjerë të quajtur Kollovo nga Eotira, dhe Jorgallaqi nga Filipadha, edhe 900 Shpirt vanë në Gjinokastrë në kryesin e oficerit Grek Z. Papula i lundur në Himarë. Në Permet na ardhë dhe shumë kapedanë të tjerë një katil i quajtur Kosta Bëcori, për këtë katil guvernua Greke jeptej 15,000 franga aju që ti shpinte kokën e tij; Kapedan Niko nga Suli, Kapedan Aristidhi nga Janina, na umblodhë në Shqipëri të gjithë Katilet e Greqise që të shpëtonin Kafshët!.....

Topat e guvernës Greke e kishin qendrën në Këlcurë në kryesin' e papa Georgjiut ky zot u murar vesh me guvernën autonome, dhe e lajmeroj që lipotaktis me gjithë topa tjetërën ditë na erdhi me një paradë me gjithë topa. Më të nesërmen bënë një mbledhje oficeret me gjithë Kapedanët ku biseduan ku të zinin kufinë Autonome, dhe vendosnë këto Kufi.


Qarku i Përmetit, zuri Brezhanin, Kosinën, Mokriçën, Hotovën, Lupçkën, gjer ne ur' e Katiut Gjinokastër, Delvina, dhe Tepelena se beshku zunë në Kodrë, në Piçar, dhe bashkohëshin gjër ne Himarë. Leskoviku zuri Gërmenjin, Arëzën, Barmashin, dhe bashkohëshin me kryengrësit e Përmetit në ur' e Katiut.

Të tre topat e këlcyrës i ndanë kështu, një top në Brezhan në kumandën e Mavrojndhiut, një në lupçkë, në kumandën e Papa Georgjiut, dhe një në Kosinë në kumandën e Kapedan Tromarës.

Kapedanët u ndanë Kesisoj!

Në Brezhan Kapdan Chuli nga Malëshova. Në kosinë 4 Kapedanë Kapedan Papa Jani, Kollovoj, Psaroj, dhe Fjorgjolaqi. Në mokricë; Kapedan Manoli nga Gjiritë, në Hotovë, Kapedan Niko, në Lupçkë, Kapedan Bubuna nga Buhali, Kapedan Qiro Chobani. Në Ogren Kapedan Zervua të githe këta katilë zunë këto kufi që thamë më sipër.






Papa Gjorgjiu Komandar i përgjithëshme të trupave Vulnetarë Përmetit. Në mes të Kryetarëvet të tjerë.



Një top i ushtërisë Greke në duar të kryengritësve Epirotë. Papa Gjorgjiu përpara tij.



PABESIA E USHTËRISË GREKE.

Më fshatin odrichan dy ore nga Permeti qeveria Grekë kish lënë 300 ushtarë dhe dy oficerë për të ruajtur kufinë. Pas vendimit Konferencës Leondonit, Qeveria Greke u zotua për keto vise që ti dorëzonte zyrtarisht në xhandermaria Shqipëtarë, dhe dorezoi këto vise, Korçën, Kolonjën, dhe Frasherin, i ardhni radha Odriçanit, lajmëroj pra kumandarin e keti trupi që ta dorëzonjë kete fshat ndër Shqipëtarët. Oficeri kur mori këtë lajme, u ngrit e ardhni në Përmet dhe lajmëroj Mitropolinë për dorëzimin e Odriçanit. Mitropolia kur mësoj këtë lajme, atë çast thiri pleqesin'e fshatit, dhe ju tha vendimin e qeverisë Greke. Pleqesia e pyetnë që ç'të bejnë. Veçil Mitropolit ju thotë që të ngrihi të gjithë me fëmijë dhe të vini këtu në Përmet, se po te rini do të vuani nga Shqipëtarët, sa për vënt do tu leshojmë shtëpira këtu në Përmet. Kur mësuani këtë lajme pleqesia u hidhruan po s' bënë dot ndryshe. Shkuan te hidhruan në fshat, ku lajmëruan fëmijën të gjitha këto. Grat' e fshatit kur mësuani zun' e ulërinin se do të linin mallë dhe shtëpitë të shkreta, po të rinin kishin frike nga mitropolia, se po të rinin do u thosh që ini Shqipëtarë dhe dotë lajmërontej ushterinë Greke që ti përvelonjë duke mos dashur lanë shtëpitë dhe mallë dhe ardhë në Përmet, ku i përndanë në për shtëpira.

Si u zbras i tërë fshati, oficeri Grek vate dhe u muar vesh me Kapedan Psaronë i cili ndodhej në Kosinë, i tha për dorëzimin e Odriçanit, i thotë pra që është një rast i mirë për të vrane Xhandërmarinë shqipëtarë, të vini të zinë pusinë që do tu i tregonj

unë. Mori Psarone më 30 andarë dhe i shpje në Qafë të Borockës, përposh që ruga që d'otë shkonin Shqipëtarët. Si mbaroj këte i pabesi oficeri vatë në Qafë të Kreshovës që të këmbenin kartrat me oficerët Shqipëtarë. Si i këmbyen, Greku ardhi në Odriçan, mori ushterinë dhe ardhi në Permët.

Oficeri Shqipëtar mori 17 xhandërmanj dhe i çkujdesur u nis për në Odriçan, kur haritnë në vend' i pusisë të pabesit Grekër ju dhanë një patare dhe i lanë në vënt, pastaj zbritnë përposh i kërkuan në për xhepe u gjetnë 50 napoleona u muar robot kepuçet; dhe hodhë kufomat në përrua dhe shkuan prapë në Kosinë.

Kur mësoj qeverija Shqipëtare këtë vrasje me pabesi u protestua të guverna Greke, po guverna Greke ju përgjeq që skam seç te bënj vëndi ka bërë kryengritje kunder jush.

Pastaj qeveria Shqipëtare dërgoj 50 xhandërmanj të tjerë në Odriçan. Kur vanë në Odriçan gjetnë fshatin të shkretë vetëm pulat dhe macet kishin mbetur. Oficeri Shqipëtar si pa fshatin të shkretë vulosi të githa shtëpitë që të mos trazohësnin plaçkat që kishin lënë Odriçallinjte, pastaj zunë kufi në Boroçkë dhe në Lipostivan.

MASAKRAT' E PARA TE GREKERVE

Një gjysmë ore lark Kosinës ku qe kufija Autonome janë dy fshatëra Paçomiti dhe Kuçari. Ndënjësit qenë myslymanë. Këto dy fshatëra me qene që qenë afër kufisë Autonome, andarët viniu gjithënjë dhe i keshilluan që po të kupetonin nonjë lëvizje prej shqipëtarëve ti lajmeronin andarët, se

ndryshe janë të humbur! Egërsirat donin shkak që ti prishnin këto fshatëra. Nuku shkoj shumë kohë po një javë që treguan barbarit e tyre.

Më 25 të Shkurtit dit e Hene ne mëngjes andarët hodhë ca patate gjoja panë ca Shqipëtarë që rynë në Pacomit. Pas patarevet u sulë të gjithë në këto dy fshatëra, dhe mblodhe të githe burat sa qenë dhe i shpunë në Kosinë dhe i mbyllë me një katua; u këthyen prapë katilet në këto fshatëra, femija që kishin mbetur në fshat u therë; pastaj u sullnë nëpër shtëpi për të plaçkitur. Muar bagetinë, 1500 krerë dhën e dhi, dhe 100 krerë lopë, pastaj u vunë zjarë shtëpive i pervëluan i bënë hi. Si mbaruan keto katilet u kthyhen në Kosinë. Nxuar burrat që kishin mbyllur dhe i shpunë me një përuea të fshatit ku i lemerisnë më thika, cave u prenë hundë, veshë, këmbë, duar të mjerët e dhanë shpirtin më lemerira që edhe Neroni të që nukë doti mundontej kesisoj. Numuri i tyre që 75 vëta si dhanë shpirtin i lanë në atë Përuea të zbuluar. Korbat dhe qentë u hengrë mishrat e tyre. Kur bënë këto therje dhe djegie andarët ushteri e regulshme e Greqisë gjendej në Këlcyre dhe në Përmet.

Guverna Greke kur pa se kryengritesit i zunë barbarite, para se të ikënjë ushteri e regulshme, dhe po ta lintej akoma do të dukej faqeza që që ajo vetë që i bënte këto, s' mënoj po urdheroj ushterinë të ikënj nga viset që ja dhanë Shqipërisë. Ushteria sa po mori urdhërin u ngritnë, ikën nga Këlcyra, nga Leskoviku, nga Tepelena, dhe nga Saranda, keshtu pra guverna Greke i la këto vise nder duar të egërsirave, të katilëve, që na i dërgoj vetë.

Më të ikur ushteria e regulshme nga Këlcyra, kryengritesit që qëndeshin në Brezhan nuku mën-

uan po u hodhe nga ur' e Meço Hysos, dhe i vanë Këlcyrës. Si uqërit u sulë në për shtepira, dhe cili pati fatin e ndënji, u ther si berri, masakruan, gra foshnja dhe ca burra. Gumezhintej gruk' e Këlcyres nga blegërimat dhe nga ulerimat. Pasi mbaruan masakrat, plaçkuan shtepitë, muar gjën e gjalle që gjetnë, dhe pastaj ju vunë zjare shtëpive; tym dhe flakë shikonje, si shkretuan Këlcyrën u sulë këtyre fshatrave që qenë afër Këlcyrës, Katundish-te, Beduqas, Fratar, dhe varibop, pun' e tyre s' qe gje tjetër përveç se zjar dhe hekur! Nje grua nga Fratari që të shpëtonte jeten e saj mori foshnjën që kish dhe mori pyllë, një Grek i quajtur Karazha e pa që po iktej u sul që ta zintej, i thiri të qindronjë po gruaja i shtrëngoij këmbet ca më shumë, si pa egërsira që do të dërsinte pa ta zinte e kish më kollaj që ta vrinte, i shtyri me pushkë, dhe e plagosi te mjerën grua në këmbë, gruaja, sa po u plagos ra përdhe me githë foshnjën pas pak minuta egërsira ariti. E gjora qantej dhe po shtrengonte foshnjën në krahuar, greku zuri ti rëmbenjë foshnjën nga duart, gruaja nuk' e lëshoj, dhe i lutej egërsirës që në ka niet të na therç, thermë mua përpara pastaj foshnjën; aman në ke Perëndi, në beson Krisht, nuke munt ta shoh foshnjën të therur, po egersira i zgurdulloj sytë dhe nxhori kamën që kul-lontej gjak. Gruaja sapo pa thikën i ra zali Greku i rëmbeu foshnjën nga duart, gruaja ulëriti, ajy plasi foshnjën përdhe dhe zuri pas zakonit që kane grekërit ta ç'nderonjë

Shqipëtarika me githë që gjendej në buzën e varit, kur pa se Greku donte ta ç'ndronjë, për të cilën Shqipëtarika e ka me të lartër nga ç'do gjë tjetër ne botë, i thotë aman vramë më mirë, e mos ma bën

këtë, nuku dua të rronj e ç'nderuar, dua të vdes me nder së kur vdes me nder, vdes e gëzuar. E mjerë shqipëtarë kërkove mëshirë nga të pa meshirë. Greku e turperoj më pahir dhe të plagosur!.....

Si mbaroj deshirën Greku, gruaja i thotë e mbushe deshirn, tani nje gjë të lutem, të më japç nje plumb që të vdes, nuku dua të rronj më në botë, vetëm të lutem fali jetën kësaj foshnjë të pafajshime. Po Greku u jep nga një thikë gruas dhe foshnjës dhe i la ne vënt. Keshtu mbaroj nisja e tragjikave. Kryengritësit u mblodhë prape ndër kufirat e para, ditën t'jater kapedanët e ketyre çetave ardhë ne Përmët ku u pritnë me nje nder të math për trimeritë që bënë!..... Veqil dhespoti ju shtrëngoj dorën dhe ju tha, ju përhironj se me të vertetë jini trima dhe me trimërine tuaj nderoni (ton Elinismon).

Sa për mundës pa fjalë dote jemi, këtë e dimë se Perëndija (tonelinon) bekon armët e Grekëve dhe kështu dotë jeni kurdoherë mundës.

Kapedanët kur panë që sa më shumë katilëke të bënin, aqë më shumë dotë nderoheshin, atë mbrëma u lëshuan në për myslymanët e qytetit, për të rjepur, u lërima, dhe blegërima digjohëshin nga mëhalla e myslymaneve, kërkonin mëshirë, po nga kush? i vanë baba Xhemalit ne Teqe si e ranë mire i muar dhe 50 lira, pastaj i vanë e slam efendiut dhe i muar dhe 50 lira, pastaj i vanë e Islam efendiut dhe i behëshin me dijën të mitropolisë. Veqil mitropolit si nje katil dhe gjakpirës, e kish ujdishur me katilin oficer Grek Kocifaqin dhe i ndanin ato që rembenin andarët në për myslymanët. Myslymanët vanë në mitropoli të qaheshin, po në kush të qaheshin? Kur ay që vete dora nga të parët e katilëve.

Po prapë i ngushllontej Mitropolia dhe ju thosh

që të mos dëshpërohen se do ta vëme tërë fuqine tonë që të mos të ngjasë gjësendi këtu e tutje. Po në vënt që ti pushontej të ligat natën, pastaj zun'ë beheshin dhe ditën. Më të nesërmet një katil i quajtur Petro nga Narta me tre shokë të tjerë vanë në shtëpi të Sali Beut, një plak i nderçim, si e ropne mire ditën me drekë i dhanë 10 thika dhe e lanë në vënt munte pragu i portes, dhe shkuan. Kur mësoj policia këtë dolli që ti ndiqtej gjoja po smundi dot ti zërë. Me pak fjalë i bënë myslymanet që s'ku-xhonin të delnin nga dera.

— — — — — 0 — — — — —

HIROISMA E NJË SHQIPËTARKE

Në fshati Ogren ku kish qendrën kapedan Zër-vua ke dhe ndënjës Myslymanë. Më këtë fsha, një myslyman i quajtur Ali kish nje çupë të bukur në vërsë 17 vjet. Katili Grek i quajtur Zaharaqi pritej rastin për të ç'ndëruar këtë vajzë. Një ditë mori dy shoke të tij dhe i vate drej në shtëpi më qellim që të mbaronte dëshirën e tij, vajza kur pa hyrjen e ketyre katileve e kupëtoj qellimin e tyre. Nuku mënoj po rendi te dalë jashtë nga një deriçk'e shtëpisë duke ulëritur, katilët kur panë që çupa u iku duall dhe këta që ta ndjekin çupën. Fshati dolli i tërë jashtë dhe shikonin me duar kryq këtë skene. Në funt të fshatit është një shkëmb i lar-ter, edhe përposh shtrihet një lum' i vogel. Chupa pra arriti dhe ipi në maj te këti shkëmbi, dhe kur ju afruan Katilët këthënet nga ata dhe ju thotë, qind-roni or barbarë, se shqipëtarka vdes dhe nuku ç'nderohet, më mir të vdes me nder, se sa të ronj me turp, mos na pandeni se jemi si gratë tuaja që se

kanë për gjisëndi turpin jemi shqipëtarë, rroftë pra nder' i shqiperisë, me të mbaruar këtë fjalë u këput nga maj' e shkënbit, dhe ra përposh.


Kështu pra e mjëra çupë u bë therore për nderin e shqipërisë. Barbarët kur panë se nuk' e mbaruan qëllimin, u sulë në për shtëpit' e myslymaneve të fshatit Kostrec i cili është shumë afër më Ogrenin, fëmija kur panë së egërsirat u sulë si uqër i lanë shtëpitë dhe muar pyllë, agërsirat rynë në për shtëpirat dhe muar ato plaçka që qenë më të vyera, dhe pastaj ju vunë zjarë dhe i bënë hi. Fëmija arritë dhe rynë në kufi të Shqipërisë dhe kështu shpëtuan jetën e tyre.




FAT' I MYSLYMANËVE TË BINDUR NË NË GUVERNEN AUTONOME

Për këtëj kufive Autonome mbenë ca fshatëra myslymanë të cilat nuk' i ndanë dot se ndodhëshin në mes të fshatërave të krishtera, të cilat janë këto! Mokrica, Zleusha, Goshnishti, Delvina, Tremishti, Pjetrani, Munushtiri, Rapcka, dhe shumë të tjera. Guverna Autonome ju zotua këtyre fshatërave që të jënë të bindur në këtë guvernë dhe do mos pësojnë gjisendi, veç këtyre fshatërave Myslymanë janë dhe ca fshatëra të Krështera që kanë dhe ndenjës Myslymanë, të cilat janë këto: Hotova, Kosova, Badëlonji, dhe Pështani Shqerisë. Këta të mjerë Myslymanë që u ndodhë ndër këto fshatëra, pesuan ato më të këqiat që janë në botë. Ne Mokricë qe një Myslyman i quajtur Muharem, ky fatzi qe shumë i pasur, kish një mije krerë bagëti. Më 2 Mars 1914 Kapedan Psaroj me ca shokë të tij ngrihet dhe vete ne Mokricë, pa si u mbloodhë të githë bagëtinë që kish fshati pastaj zun' e turpëronin cila grua u pëlqentej. Burrat e fshatit i mbloodhë më një vënt dhe i shtruan në dru, si mbaruan këto vanë në shtepi të Muharmit, ky fatzi kish dy vasja të vogëla të cilat nuku ju duall në sesh këtyre egërsirave, po këta duke kërkuar shtepinë më në funt i gjetnë të fshehura brnda në musendërë, i zunë prej gërshetave dhe i nxuar jashtë, dhe zunë të dëfrenin njera qe 12 vjet dhe tjetëra 10 vjet.

I mjeri atë gynjëzoi përpara egërsirave dhe ju lutej që të mos ja ç'nderonin çupat se përveç ç'nderit janë të vogëla. Po ata ju pergjeqnë s'ka gisendi se p'se jane të vogëla, se neve kemi ardhur për të ndruar farën!..... Duam t' ju bejmë Grekër siç kini



Trupa Vulnetare Gjiritas Nënë Kryetar Migda



qëne më parë. Muharemi ju thotë me zë te drithtur, malle ma muart ju a bënj allall po ju jap dhe 50 lira që me kanë mbëtur, me së fundi dhe shpirtin im, po vetëm çupat dua të mi lironi. Ata i thone Muharemit po të na japç 100 lira munt të ti lëshojmë. Muharemi ju përgjeq unë këto kam më vehte, po të më jepni, lejen të vete në Përmet atje gjenj dhe do t' ju jap dhe 50 të tjera.

Mirë i thanë nëmna tani të 50 lirat që ke aty dhe mer këtë ushtar dhe çap në Përmet.

Psaroj heq më njane katile që do ta nistej dhe itha mere këtë qcn nxire jashtë fshatit jepi një plump dhe lëre në vënt që ta hanë qentë. U nis i mjeri Muharem bashkë me katilë për në Përmet. Nuk' u larguan shumë nga fshati kur harritne më një Përhua atje katili i këthen mahuzerë Muharemit në kraruar i jep një plump dhe e la në vënt pastaj u kethye prape në shtëpi te atij.

Në shtëpi gjeti Psaronë me shoket e tjerë që po dëfrenin me të mjerat vajza!..... Më të nesërmen e lanë këtë fshat, dhe vanë në fshatin tjetër që qe afër në Zleushë, dhe këtu punuan ato të Mokricës u mblodhe bagetinë, lopët, kafshet dhe i lanë të mjeret duar thatë, te githe këtë mall që mblodhe i ndanë në mes të tyre, dhe i derguan në për shtëpirat e tyre. Kur shkonin bagetija më mijera krërë për në Greqi, vendesit Grekomanë, që i shikonin për së largu dhe mallëkonin vehten që u benë shkakëtarë që suall këta katile që u shkretuan vëndin po tani që von se keta ju vunë frënë vëndësve dhe i lonin si të donin.

Të githa këto ju punoheshin Myslymanëve të cilet rinin më duar kryq duke pritur mëshirë nga Perëndia.

HIROISMA E NJË ZONJË NGA ZLEUSHA

Me 13 Mars dy katilë Grekër të quajtur Aleko dhe Karaxha nga Narta, vanë në fshatin Zleushë, ku qe një zonjë të cilës i kish falur zoti të githa të mirat. Nuku kish më shumë se 4 muaj që që martuar. Një mbrema tek po rinin reth vatrës një trokitje u dëgjua ne porta, me vrap dolli i zoti i shtëpisë të shikonje se kush ishte. Dolli jashtë dhe pyeti kush që po një zë u dëgjua jashtë portës me fjalet hap dhe mos u trëmp.

I mjeri i kupëtoj që s' qenë Shqipetarë se Shqipen e flisnin si të belbër po s' bentej dot ndryshe e hapi derën më të hapur dera rynë katilet dhe ay i mirë priti. Siç ndëjnë pak, ju shtroj për të ngrënë bukë, pas buke i thonë katilët që duam te flemë, dhe ay u shtroj më një odë për të fjetur. Si i bëri gati ju thotë që hazër janë dyshekët për të fjetur u ngrinë të dy katilet dhe vanë në dhomë dhe i zoti i shtëpisë ju rintej në këmbë gjer sa të binin ne dyshek. Tek po zunë sikur të zvizhëshin Alekua nxori një litar nga mesi dhe Karaxhaj më vrap e zuri të shoqin e zonjës dhe Alekua po e lithtej. Si e lithne mire vanë në dhomën tjetër ku gjendëj Gruaja, rynë në dhomë dhe e zunë Gruaja me pahir dhe e suall në dhomën ku që lidhur i shoqi. Atje Alekua i hodhi duart në qafë dhe zuri ta puthtej. Gruaja u përpoq dhe se la ta puthtej.

Ahere më një zë të drithtur ju thotë i qindroni egërsira, që s' paski as Perendi, as Krisht, të githa na i punuat, malle na e muart, burrat, vellezërit, dhe prinderit na i vratë, me së fundi na arthte dhe në ç'nderim, nuk e dini që shqipëtarë të githa të ligat që i vinë munt t'i duronje, përveç së një, dhe

kjo është ç'nderim! Prandaj atë që kini ndër mënt ju nuku munt ta mbaroni gjer sa shpirti t' im është në kufomë, si të më dalë shpirti nga kufoma munt të më beni c' t'ë doni, po do të jem e vdekur, dhe nuku do të sho gjë do të vdes pra e gëzuar dhe me nder. Po ju lutem pra më oren e fundit që të kini meshirë dhe zgjithni burin tim. Si kur të qetë ju në vënt të burit tim, dhe të shikonit gruan tuaj të turperonej përpara syve si do t'u vinte? Mejtoni ketë dhe lernani të lire! Po Greku në vënt të mëshirës i zgurdulloj syte Gruas dhe ju sul që ta vintej poshtë.

Shqipëtarja po mburontej veten esaj me duar, më së fundi Greku nzori kamën dhe ja mati ti ja ngulte në barkut, Zonja si pa që nuku kish shpëtim ju vërvit Grekut dhe ja zuri Kamen me duar dhe po mundoesh ti ja mertej, dora e saj ju bë thela dhe Kamën nuk e lëshoj, shoku i tija si pa që nuku që e mundur që ta bënin shqipetarkën si të donin ju sul methikë dhe ja nguli në barkut! Zonja sa po ndjeu thikën në barkut ra përdhe, dhe duke ecur shpirt tha tani po vdes munt të me bëni si të doni, vdes me nder! I shoq' saj që lidhur po e shikonte këtë scenë dhe po derthtëj lot, keshtu pra emjera Zonja i dha funt jetës saj për nderin, po Greku barbar, duke hequr Shpirt Zonja aju po mbushtej dëshirën! Në orën e fundit te saj!.....

OFFENSIVA E ARËZËS

Siç thame më sipër, qarku i Leskovikut kishin zënë kufine në fshatin Arëzë dhe Barmash, nënë kumandën e Kapedan Fjorgakaqi, Shqipëtarët kishin zënë kufinë në vari Chobanit dhe zbritëj gjër në

lumi Barmashit. Shqipëtarët nuku donin kurrë t' ju jepnin Chik Grekërve, vettëm zunë kufinë për të mbrojtur nderin e Shqipërisë. Po Grekërit që kishin ardhur vetëm për të treguar barbaritë e tyre, dhe për të shkretuar Shqipërinë kërkonin shkak për të mbaruar qëllimin e tyre. Mbi fshatin Shalësh është një fshat që quhet Leshnjë me ndënjës Muhamedanë, Grekërit ju sule këti fshati si bisha dhe ç'gjenin përpara i shkonin në thikë, gra, bura, foshnja u masakruan prej egërsirave, rugat e fshatit u mbushnë me kufoma, pastaj ju vunë zjarë shtëpive dhe i bënë hi!.....

Shqipëtarët të cilët nuku qënë shumë lark nga ky fshat, si panë tym dhe flagë, nuku menuan po u sulë kundra Grekërve. Pas një luftë të reptë ju dhanë datën, i vunë përpara si kecërit, dhe ju dhanë një tmer të math sa nuku gjenin vrimë se ku të futëshin, i ndoqmë gjer në Leskoviç dhe zunë Grykën e Postenanit. Grekërit më të shkuar nga Leskoviku i vunë zjarë dhe e bënë hi. Në këtë luftë u plagos dhe kumandar' i çetave Grek Kapedan Fjorgakaqi, të cilën e shpunë në Janinë për të shëruar. Vëndësit e Leskovikut, dhe të fshatërave rotul si panë panikun, për të shpëtuar jetën e tyre, dhe të femijes u ngrinë dhe muar rugat për të gjetur mbrotje në mes të hurave, atje që dhe ushtëria e regullshme e Greqisë. Po Grekërit me gjithë që gjëndeshin në këtë panik nuk' i lanë të qetë këtë popull që po gjesdistej rugave për të shpëtuar jetën e tyre që lanë gjë dhe mall shtëpi të shkreta dhe duall me robat e trupit nuku qënë miaft këto, po ja të shikojnë dhe gratë, vajzat e tyre të turperonën në për rugat prej barbareve Grekër, gjer sa harrinë në mes të hurave. Sheshet që janë në mes të hurave

u mbushnë plot femijë. Qeverije Greke u hapi ca tenda dhe u ala që të gulnin femijën, dhe u jeptej nga një copë buke për të mbajtur shpirtin: Po edhe andarët me atë panik që muar, dhe ata vanë në mes të hurave, po qeverija Greke nuk i qasi atje, se ju tha të vini të vdisni atje. Ju dha dhe ushtëri tjtër dhe unisnë të ndiqnin Shqipëtarët nga Leskoviku dhe nga gryk' e Postenanit.

ATË STATHI MELANI

Siç thame me sipër që shqipëtarët si vunë andarët e qarkut Leskovikut përpara, zunë grykën e Postenanit. U muar vesh paniku i andarëve dhe në qarkun e Permetit, vëndesit e qarkut Përmetit, dhe të Permetit duk me parë përparimin e Shqipëtarëve nga an' e Leskovikut ishin të sigurtë që qarkur e Përmetit Shqipëtarët do ta mbyllnin brënda, nga ana tjtër e dinin fort mirë që andarët Grekë po të thyeshin kishin Program që të diqnin gjithë shtëpirat të Kreshtera, dhe ta bënin vendin hi dhe pluhr, që kështu Shqipëtarët ta gjenin vendin të shkretë. Po përgatiteshin pra të ngrinin femijën dhe të vinin në Janinë. Mblodhë të gjithë Plaçkat e tyre dhe i dërguan në Janinë, dhe vetë po prisnin orën e fundit që të shkonin.

Shqeria si u Perndanë andarët e Leskovikut-mbeti bosh, vetëm në fshatin Melan gjendej At Stathi me një çetë të vogël prej vendit. At Stathi është një prift Shqipëtar me ndjenje Kombëtare, po me qënë që ndodhej në në bajonetën Grekë nuku kuxontej ti çfaqtej ndjenjat e tija, nga e keqja kish marë kumandën e asaj çete në Melan, dhe po pristëj orën që të bashkonej me Shqipëtarët.

Nuku mënoj shumë, se Shqipëtarët si zunë Grykën e Postenanit hodhe lumën e Barmashit, dhe zunë

fshatin Radinisht, Peshtan, Kreshovë, Içgar, Ogdu-
nan, dhe Delvinë, ketu qindruan.

Andarët e qarkut Përmetit i zuri data kur mës-
uan që Shqipetarët zunë Delvinën, se pa fjalë do të
mbyllëshin prej Shqipëtarëve. Kumandar' i Për-
metit i dërgoj At Stathit një ndimë prej 50 vetash
nënë kumandën e Kapedan Josifit nga rëza, At
Stathi mori kurajo të math se i ardhi ora që të tre-
gontej atdhetarismin e tija. Ju dha urdhër çetës
kur pa që Kapedan Josifi po vinte në Melan, që ti
binin së jane Shqipetarët ju tha çeta e tij pa ditur
se që ndihm' e tyre, ju dhanë një patare. Po dhe
Kapedan Josifi ju përgjeq pateresë, dhe pas gysmë
ore luftë Kepedan Josifi si epa pisk mori shoket dhe
iku duke lene një të vrarë dhe një të plagosur. Pan-
dëu së Shqipetarët kishin zënë dhe melenin. At'
Strathi kur pa çeta ndihmetare u përnda mer të birin
e tij dhe vatë në Delvine ku u bashtkua me Shqipe-
tarët. Cheta e At Stathit, e kupëtuan që At Strathi
i gënjeu, u zëmëruan keq dhe vanë në shtëpi të tij
dhe gjetën të shoqen e At Stathit bashkë me të dy
femjët e saj i zunë dhe i dërguan në Përmet, dhe
shtepise i vunë zjare.

Kur vanë mandataret ne Përmet i thanë Ku-
mandarit per tradhëtin' e Atë Stathit. Kumandari
Z. Kocifaq kur mësoj këtë ngjarje zgurdulloj sytë
dhe tha, a! Trathëtor do të nisem vetë dhe do të
përpiqem ta zë të gjallë, dhe një dashtë zoti që ta zë
të gjallë do ta shkonj ne hell qeratanë. Nuku mënoj
Z. Kocifaqi po pregatiti ushtërin'e tij dhe u nis për
ne Melan.

OFFENSIVA KUNDËR SHQERISË

Qeverija Grëke kur pa qe andarët që kish dërguar po thyëshin nga çdo anë, dhe për të mos dërgonte tjetër ndihmë, Shqipëtarët do të zinin mesn' urave. Dërgoj pra një oficer me një 100 Shpirt në krainën e Leskovikut, Kumandar' i trupave Leskovikut umuar vesh me Kumandarin e Përmetit që tu bënin offensivë Shqipëtareve. Kumandar' i Përmetit i dërgoj dhe një top Kumandarit Leskovikut dhe shënuan ditën e offensives e cila që 2 Prill, 1914. Dita ardh dhe pas fjalës që kishin bërë trupat e Përmetit do ta zinin luftën me Parë. Kocifaqi zuri qafen e Melanit, trupat që gjendëshin në Lupcke nënë Kumanden e Pappageorgiut gjysmët zunë tabor' e Ogrenit dhe gjysmët zunë brëgun e Kostrecit, dhe topin që kishin në Lupcke e shpunë mbi Kostrec.

Atë ditë më ora 4 në mëngjes Kocifaqi ju dha urdhër trupave të tij të zinin luftën kundër Delvinës. Ushtria pas urdhërit Kumandarit zunë pataren kundër Delvinës. Po dhe Shqipëtarët si breshër ju përgjeqnë Grekëve. Pas pak minutash dyfek Pappa Gjeorgjiu i vuri zjar topit dhe bombardistej Delvinën, po trupat e Leskovikut kur digjuan që ofensiva zuri kundër Delvinës nuku mënuan po zunë dhe ata dyfegun kundër qafës Postenanit dhe top'i tyre po bombardhonte Tabjet'e Shqipëtarëve. Lufta po bënej e reptë e cila mbajti tërë ditën dhe nuku mundtë dot ti çkulnin Shqipëtarët nga positat e tyre gjer sa u ngrus dyfegu dhe topi nuku reshti, ndaj të ngrysur zuri një vesë shij u shtrënguan pra ta pushojnë dyfegun. Shqipëtarët që gjendëshin në Del-

vinë atë natë u shtrënguan talënë Delvinën se vendi nuku qe tratigjik dhe po të rinin për të nesërmen do të zireshin të gjallë, atë mbrëma e lanë Delvinën dhe zunë qafën e Peshtanit. Qaf'e Peshtanit është një vend stratigjik. Me të nesërme kumandari Grek ju dha urdhër trupave që të ithnin patarë kundër Delvinës, po në këto patare nuku u përgjeq njeri nga Delvina kumandari e kupëtoj që Shqipëtarët e kishin lenë Delvinën.

Ahere Kumandari nuku mënoj po ju derth Delvinës. Të Krishterët e Delvinës kur panë se po vinin andarët, duall jashtë dhe i pritnë me këngë. Myslymanët e Delvinës kishin ikur bashkë me Shqipëtarët dhe kishin lënë shtëpit'e tyre me gjithë mall të shkretë. Si rynë Andarët në Delvinë u derdhë nëpër shtëpit'e Myslymanëve, u hapnë dyhert i plaçkuan dhe pastaj u vunë zjarë dhe i bënë hi. Shqipëtarët që qenë në grykën e Postenanit nuk'u thyen, po prapë ditën tjetër po lëftonin reptësisht. Andarët e Permetit si mbaruan nga Delvina u hodhë në fshatin Kreshovë 1 orë lark Delvinës, dhe në këtë fshat andarët u pritnë me nder të math. Si ndenjnë pak të çlodhen në këtë fshat u nisë të shkonin për në Peshtan duke shkuar me një vërejtje të madhe se nuk'e dinin se ku kishin qindruar Shqipëtarët. Si u afruan në lum'i Peshtanit, Shqipëtarët nga qaf'e Peshtanit ju dhanë një patarë, lufta u ndes e reptë. Grekërit u dëshpëruan se vëndet që kishin Shqipëtarët qenë shumë të forta, dhe nuku do të mundnin dot ti çkulnin nga vëndi.

Ahere Kumandari Z. Kocifaqi dërgoj një mandatar në Lupçkë ku qe Pappa Gjeorgjiu, ku i thosh që të mertej topin dhe ta shpintej në Kreshovë dhe se andejmi të bombardhistej qafënë e Peshtanit dhe

fshatërat rotull. Pappa Gjeorgjiu nuku mënoj po mori topin dhe e shpuri në qafën e Kreshovës. Dita u ngrys dhe lufta s'kish reshtur, që nga gryk'e Postenanit gjer në Peshtan tym dhe flagë shikonje, si u erë, lufta pushoj. Me të nesërmen që pa gdhire zuri lufta nga të dy anët, topi nga qaf'e Kreshovës po bombardhontej pa pushim qafën e Peshtanit dhe fshatërat rotull Icgar, Radimisht dhe Barmash. Trupat Shqipëtare që qenë në grykë të Postenanit atë ditë lëftuan 10 orë burërisht kundër Grekëve, po mjerisht nuku muntënë të qindrojnë më se Grekërit qenë me të shumë, dhe topat 10 orë nuku pushuan së bombardhisuri. U shtrënguan pra ta lenë grykën e Postenanit. Si u er iknë dhe qindruan mbi barmash. Grekërit atë mbrëma se kupëtuan se i lanë vëndet Shqipëtarët. Ditën tjetër si u gdhi, lufta zuri më parë prapë në Peshtan, Shqipëtarët që qenë në qafën e Peshtanit nuk' i lanë vëndet, dhe se kupëtuan që Shqipëtarët'e Postenanit i kishin lënë vëndet, natën e parë, përandaj prapë atë mëngjes zunë pushkën me qëllim t'u dërmonin eshtrat barbarëve. Po u gënjyen, se trupat Greke si panë atë mëngjes që Shqipëtarët kishin ikur muar udhën dhe ju afruan Barmashit. Me të afëruar në Barmash u përpoqnë me Shqipëtarët u bë një luft'e reptë gjer sa i shtrënguan Shqipëtarët ti lenë vëndet, Grekërit rynë në Barmash dhe i vunë zjarë. Shqipëtarët që qenë në qafën e Peshtanit kur panë që Barmashi po digjej e kupëtuan që qenë në rezik se do të rethoheshin vendosnë pra t'a lenë Peshtanin. U ngritnë ca nga ca dhe iknë dhe u bashkun me trupat e tjera që qenë përtej lumit Barmashit. Në këtë luftë Grekërit lanë shumë të vrarë dhe të plagosur. Grekërit kur panë që Shqipëtarët e lanë qafën e Peshtanit ju derdhë

këti fshati në Peshtan qenë dhe 30 fëmije Myslimanë të cilët nuku muntë të shkonin bashkë me Shqipëtarët po fati i la atje që të shikonin lemerira. Si rynë egërsirat në fshat, të Krishterët bashkë me Myslimanët u duall përpara që ti pritnin ato egërsira! barbarët pra sa po rynë mblodhë të gjithë burrat Myslimanët të cilët bënë një sumë prej 40 veta dhe i shpunë me një përhua jashtë fshatit dhe i vunë në patarë, i vranë dhe i lanë në përhua, pastaj u kthyen në fshat mblodhë të gjitha gratë dhe çupat dhe i mbyllë më një shtpi.

Foshnjat e mjera po sheshitnin rugat duke ulëritur dhe kërkonin prindërit e tyre. Egërsirat pra i mblodhë të gjithë foshnjat dhe i shpunë me një shtëpi ku kish një pus dhe atje i mernin foshnjat një nga një uprisnin kokat dhe i ithnin në pus. Suma e foshnjave që therë qe 27. Si mbaruan së theruri foshnjat pusin e mbuluan me gurë. Pastaj plaçkuan shtëpitë dhe u vunë zjarë dhe i bënë hi. Plaçkat që muar nga Peshtani i dërguan në Delvinë ku kishin dhe të tjerat. Tani ardhni radh'e grave. Muar të mjerat gra dhe i larguan nga fshati ku me një shesh ndenjnin atje Kocifaqi ju tha andarëve jini të lirë të defreni me këto gra. Zunë pra egërsirat dhe po mbushnin dëshirat e tyre. Si mbaruan së defryeri u shkuan bajonetat dyfekëve, dhe i çponin të mjerat gra gjer sa dhanë shpirtin!.....Kështu mbaroj scena tragjike e Peshtanit. Nga Barmashi Grekërit i thyen Shqipëtarët dhe duke shkuar dhe duke djegur fshatërat që gjenin po i rynin Kolonjës, vanë gjer në fshatin Ngjonç dhe qindruan. Trup'i Kocifaqit u këthye prapë në Përmet. Ky trup në ur'e Badelonjit qindroj se Badelonji ka dhe ndënjës Myslimanë. U ngjitrë në fshat dhe thirë myftarin e fshatit që tu

tregonin shtëpit'e Myslimanëvet se do ti bastisnin thanë për armë. Myftari u a tregoj dhe këta u lëshuan si bishat në për shtëpirat mblodhë të gjithë burrat sa gjenë dhe i mbyllë më një shtëpi. Pastaj vanë të kërkonin shtëpitë u hapnë kasellat muar para, unaza, ora, berzylake, dhe ç'do gjë që gjenë të vyer. Ch'nderuan gra, kur vanë në shtëpi të hoxhës Badelonit ky kish një çupë në vërsën 16 vjet ju mblodhë së mjerës vajzë 30 shpirt dëfryen dhe e lanë më gjysmë shpirt vajza u derg dy javë në krevat dhe dha shpirtin! Si mbaruan së dëfryeri u vanë burrave i shtruan në dru dhe ju thoshin ku i kanë armët të mjerët ç'të jepnin kur nuku kishin? Më së fundi u kërkuan të holla të cilët sa kishin me vehte ju a dhanë. Si u muar dhe të hollat i lanë të lirë. Kështu vanë të mjerët në për shtëpira me gjysmë shpirti, po në shtëpi ç'gjetnë? fëmijën e tyre duke qarë të cilat po u tregonin ç'u punuan katilët, po ç'të bënin? Ku të qaeshin? Kush do t'ju jiptej të drejtë?

OFFENSIVA KUNDER KOLONJES DHE TE FRASHERIT.

Trupat'e Leskovikut që gjendeshin në Gjonç dhe në Borrovë ndejnë gjer më 20 Prill pa bërë no një luftë. Ditën e 20 të Prillit zun ofensivën kundër Kolonjës. Pas një luftë të reptë Shqipëtarët u thyen në këtë luftë Sali Butka rethoj një trup Gjiritas prej 160 vetash nga të cilët vetëm 80 veta shpëtuan. Si u thyen Shqipëtarët Grekërit ju rynë fshatëravet Kolonjës duke djegur, tym dhe flagë po deltej nga

malet e Kolonjës. Trupat e Permetit që gjendeshin në tabor të Ogrenit kur shikonin tym dhe flagë që po deltetj nga malet e Kolonjës po gëzoheshin dhe pyetnin njeri jatrën (ti dhjavollo? pote tha ekomen ap'edho panigiri?) Trupat e Leskovikut arritnë duke djegur fshatërat gjer në vakëfet. I rynë Luarasit i vunë zjarë. Në këtë fshat dogjë dy fëmije të Krishtera se u kallëzuan si kombëtarë. Gjithë fëmija e këtyre fshatërave muar rugat dhe harritnë në Lupçke. I rynë anaritet në këtë fshat therë 275 vehta, fshatin e dogjë. Këtu andarët qindruan, të gjitha këto u bënë më 3 dit. Kumandar i trupave Permetit Papa Gjergjiu kur pa që Kolonja u do e tërë vendosi dhe ky të bënë offensive kundër Frashërit, dita qe 23 Prill duke ngdhirë e Diel.

Të shtunën mbrëma u mbloodhë në tabor të Ogrenit të gjithë Kapedanët që të bënë pllanin e offensivës, pasi u muar vesh se ku si cilë dotë zintej vënt. Lajmëruan ushtarët që të bënëshin gati se me të nesërmen doti binin kokojkës Frashërit Si shkoj mes'i natës ç'do Kapedan thiri trupin e tij për të vatur në vendi që e urdhëroj Kumandari. Kapedanët u ndanë kësisoj: Kapedan Zerva dhe Kapedan Farmaqi një çoban nga Kosova doti binin Zavalanit nga Ogreni. Kapedan Bubuna nga Buhali, në qaf'e Korbit. Qirovaso çoban dhe Kapedan Begori në vgje Lake Kosina çoban dhe Kapedan Nkio Grykën e Borockës. Zuri si cili vendin. Topin e suall në tabor'i vjetër dhe grykën ja këtheu Kokojkës. Sa po zuri të zbardhëllenës nga an'e Qirovasës zuri pushka, me një herë zuri e tërë vija dhe Shqipëtarët po përgjigjeshin si mitralloz. Pas pak minutash zuri topi të bombardhontej Kokojkën, me gjysmë orë hodhi 80 gjyle. Nga Shqipëtarët po rallëcohej dyfeku.

Shqipëtarët si panë se nuku mbaheshin dot me se u a preu kurajon Kolonja ndenjné ca të pakë në Kokojkë të mbanin mbrojtje gjer sa të shkontej fëmija nga Selenica dhe nga Frashëri.

Si panë andarët që u rallësua dyfeku nga Shqipëtarët u sulë, Qiro Vasua me Kostë Beçorin drejt mi Kokojkë. Shqipëtarët iknë pastaj u sulë të gjithë trupat andarët dhe i vanë Kokojkës atje gjetnë dy Xhandarmanj Shqipëtarë të vrarë. I vanë Selenices, në Selenice s'kish mbetur njeri vetëm shtëpitë gërmadha, plaçkat e tyre i kishin lidhur dhe i kishin bërë denga gati për të ngritur, po nuku haritnë të gjitha këto denga i ngritnë andarët dhe si i mblodhë më një shesh ju vunë zjarë shtëpive. Vanë në Frashër, në Frashër të Krishterët kishin mbetur, të cilët duall përpara që të pritnin uqërit. Këta si rynë në Frashër ju sulë dyqaneve i hapnë dhe u muar plaçkat, të Krishterët po ulerinin se qenë plaçkat e tyre, po ata ju thoshin që edhe ju Turko-Allvanj jini, pastaj u derdhë në mehallë të Muhamedanëve, ju vunë zjarë shtëpive. Një Muhamedan i cili kish mbetur me gjithë të birë e gjetnë mb' udhë dhe i vranë që të dy në mes të udhës, i vanë Teqesë. Në Teqe kish mbetur një dervish dhe një plakë të cilët kur panë që vinin andarët në Teqe duall në porta, po ata s'i pritnë po i vranë edhe rynë në Teqe mblodhë të gjitha plaçkat që kish Teqeja pastaj i vunë zjarë. Të gjitha shtëpitë e Frashërit kishin nga një Flamur të Shqipërisë në për dritare të cilët u doqnë bashkë me shtëpitë tym dhe flakë u bë Frashëri. Frashëri që ka nxjer hyjt'e Shqipërisë. Ku jeshë ti o shpirt i të pa vdekurit Naim Be? Ku jeshë atë minutë të shikonjë Frashërin? pse nuku delnjë ta ligjironjë? me atë kjuhën e embël? po jo një zi, një

pushim vdekje kish mbuluar Frashërin.....Pas Frashërit vanë në Kreshovë, zjarë dhe atje, vanë në Miçan zjarë dhe atje. Këtu gjenë 13 gra të cilat i shkuan në thikë. Dyfegu po kërcitej nga an'e Boc-kës dhe Lipostivanit. Këtu Shqipëtarët po lëftonin burërisht. Në Lipostivan qe trimi me fletë Bilal Lipostivani i cili nga Teqeja po luftonte kundër 300 vetash, nuku shkunj thosh Bilali, dua të vdes këtu. Kapedan Manoli një Gjiritas ju derth që ta zintej të gjallë Bilalin, po nuk' hariti se plumbi'i Bilalit e gjeti mun'në ballë dhe kafshoj dhenë. Borocka u thyhe, po Bilali jo, i shkuan shokët mbeti me katër vetash po gjene po lëftontej gjer sa një plump i shkretë e mori në maj të kokës, ahere shokët e muar edhe iknë. E shpunë Bilalin gjer në Berat ku atje dha shpirtin ky trim. Andarët rynë në Borockë, zjarë, në Pagri, zjarë, në Lipostivan, zjarë, në Stevran, zjarë, në Fratar zjarë, në Seniçan zjarë, këtu qindruan.

—o—

VRASJE KOSTE BECHORIT

Ky katil qindroj në Miçan me gjithë trupin e tij. Si shkuan ca dit që nuku bënej no një përpjeke, ky dinak zuri miqësi me Shqipëtarët dhe i këshillonte që të vinin si cili në vent të tij dhe ju zotohej që të mos pësonin gjisendi. Një ditë Shqipëtarët i bënë një gosti në Koprenckë ku ftuan Koste Beçorë dhe ky vate me ca shokë të tij në gosti. U pritnë mirë prej Shqipëtarëve sa këmbeu dhe dyfekun etij me një Shqipëtar. Si u mbarua gostija shkuan, me të shkuar ftoj dhe ky Shqipëtarët për një gosti, dhe Shqipëtarët i dhanë fjalën që do të vinin. Po ky

nuku kish ndër mënt që ti gostitej Shqipëtarët siç e gostitnë, po vate pas mënyrës që ka Greku do me thënë pabesinë. Ky katil kish ndër mënt që si të vinin Shqipëtarët që të anin gostinë ti vrisnin që të gjithë. Ky pllan i vate në vesh Kumandarit Grek Papa Gjeorgjiut i cili e ndalloj që të bëntej këtë pa burrëri dhe kështu shpëtuan Shqipëtarët. Një ditë tjetër vate në fshatin Verzhezhe ku u prit prej Shqipëtareve të ati fshati, hëngrë, pinë, me mishra të pjekura dhe me të tëra të mirat. Kish vatur vet'i katërtë. Pasi e bënë qejfin puçkë u lipsej dhe një tjetër. Kjo qe zakoni që ka Greku që të ç'nderonjë. I Zoti i shtëpisë kish një vajzë e cila i ryri në qejf Beçorit dhe dontej ta mertej me vehte që ta kish për të shkuar kohën. I jati çupës ja kupëtoj pllanin që dontej të bëntej dhe me marifet dërgoj djalin e tij që të lajmëronjë shokët e fshatit, ç' do të ngjistej. Shqipëtarët e fshatit muar armët dhe zunë vënt që ta prisnin kur të deltej nga der'e shtëpisë. Kur u bë gati për të shkuar u bëri me sy shokëve që të qenë gati të zinin çupën. Po para se tazinin çupën doli në dera se i diqte miza mos kish njeri. Sapo ngjati kokën nga dera jashtë Shqipëtarët që e ruanin i dhanë një plump munë lulen e ballit. Beçori ra posi një ka dhe thiri (me efagan i allvani) më hëngrë Shqipëtarët të tre shokët e tjerë si digjuan dyfegun, dhe zërin e Beçorit duall të shikonin ç'ngjau. Po Shqipëtarët më si pritnë po ju dhanë nga një plump dhe i lanë në vënt. Pastaj vanë që të mernin kufomat dhe ti vinin në gropë. Beçorit i gjenë shumë të holla në çantë, pasi i shtypnë kokën me gur i hodhë që të katër më një gropë ky qe fund'i Koste Beçorit që nuku mundej ta zinte guvernë Greke.

OFFENSIVA E KURVELESHEVE KUNDER PICARIT.


Trimat e Kurvëleshit gjendeshin në qaf'e Picar, vendosnë që t'u bënin një offensivë andarëve, pas Këngës popullore që thotë, "Këta djemt'e Kurvëleshit lëftojnë me palë sheshit." Me të vërtetë ashtu e bënë dhe jo vetëm burrat, po dhe gratë si Spartiatka duall me sëpata ndër duar. Dita e hënë 22 Prill sa po u zbardhëllua Kurvëleshasit ju vunë zjar dyfegëve dhe ju a dhanë andarëve. Dyfegu zuri i reptë nga të dy palët. Një plak Nivicjot floke bardhë me një jatagan të qimoçim kish dalë përpara trumbës dhe shkotej përpara duke dhënë kurajo djemëve. Andarët po lëftonin burrërisht po Kurvëleshasit ju jipnë përsipër. Andarët u thyhen gjer në Manastir të Chepos, atje qindruan tu bënin ballë Shqipëtarëve. Po Shqipëtarët nuku pëshuan plumba po përpara mbi ta. Këtu kafshuan dhenë nga andarët 160 vehta, dhe u thyhen nga manastir'i Chepos. Shqipëtarët po i ndiqnin si kecërit dhe haritnë gjer në Oviro 2 orë nga Gjinokrastra, këtu Shqipëtarët qindruan.

Kur mori vesh Zografua që Shqipëtarët haritnë në Oviro, e zuri data, nuku mënoj po ngriti Qeverinë dhe e shpuri në Delvinë.

Një të tillë offensivë ju bënë Kolonjarët andarëve gjithë atë ditë të cilët i thyhen. Shqipëtarët pravinin përpara nga dy anë. Nga Gjinokastra dhe nga Kolonja. Zografua duke parë që Shqipëtarët fitonin nga dy anë, vetëm mesin kishin lënë prapa do me

thënë qarkun e Përmetit kish frikë se mos bënin no një stratigji Shqipëtarët për të mbyllur andarët e Përmetit që të bashkoheshin Shqipëtarët e qarkut Kolonjës, me Shqipëtarët e qarkut Gjinokastrës në mes të urave dhe kështu të mbyllnin andarët e Përmetit. Prandaj telegrafoj Kumandarit Permetit që të mbledhë andarët dhe të shkonin për në mes të urave. Sa po ardhi kjo lajme në Permet data i zuri vendesit se dotë ngrieshin të gjithë për në mes të urave. Kumandar'i Permetit lajmëroj të gjithë trupat për të ikur. Të gjithë fshatërat të ngrinin fëmijën për në mes të arave. Andarët ju dha urdhër që tu vinin zjarë të gjithë fshatrave të Krështera që kështu Shqipëtarët të gjenin vetëm gërmadha. Zjari ndër të Krështerët u nis nga Frashëri. Kumandar'i i trupave të Frashërit lajmëroj të gjithë trupat të mblidheshin në shesh të kishës. Të Krështerëve të Frashërit ju dha urdhër që të mernin fëmijën të linin shtëpitë dhe të vinin për në Permet. U nisnë të mjerët Frashëllinj me robat e trupit, dhe muar rugën për në Përmet. Pasi u mblodhë trupat në shesh i Kishës. Kumandari ju thotë urdhërin që kish marë dhe ju tha që t'ju vinin zjarë shtëpive të Krishtera. U lëshuan pra andarët me pishë në dorë dhe ju vunë zjarë të gjithë shtëpive dhe si të mbaronin Frashërin do të zinin fshatërat e tjera me radhë. Zografua po thëristej për ndihmë se ndryshe genë të humbur, ahëre guverna Greke urdhëroj nënë Generallin Papulla i cili gjednej në Jorgocat që tu dërgonte ndihmë. Papulla u nis vetë me ushtëri për në Gjinokastrë, dhe në Permet dërgoj Kollonelin Ciruli që të qetësonte vendin dhe të pushonte zjarë të fshatrave të Krishtera. Me të ardhur Ciruli në Permet dërgoj një mandetar në Frashër për

të pushuar zjarë, po kur ardhni mandari në Frashër, Frashëri qe mbaruar. Hariti vetëm fshatërat e tjera. Fëmija e të gjithë fshatërave të qarkut Permetit u mblodhë në Permet. Sheshët e Përmetit u mbushnë me fëmijë. Shumë fëmijë u ropnë prej andarëve dhe shumë gra u ç'nderuan. Si u vate ndihmë qarkut Gjinokastrës ditën tjetër ju bënë offensivë Shqipëtarëve të cilët pas një ditë luftë u thyen. Ndihma q'ëju vate andarëve qe e madhe dhe dy topa po rinin pozitat e Shqipëtarëve. S'kishin seç të bënin Shqipëtarët përveç se të shkonin. Andarët po i ndiqnin këmba i këmbës dhe duke djegur fshatërat që gjenin përpara i rynë Kurvëleshit të cilën e dogji. Vanë në Hormovë të mjerët Hormovitë kuxuan e ndenjën, si rynë andarët në Hormovë mblodhë të gjithë njerëzit e fshatit të cilët bënin një sumë prej 160 veta dhe i shpunë në Kodrë. Hormovës i vunë zjarë. Vanë në Luzat, zjarë dhe rynë në Tepelenë hapnë dyqanët që qenë pa zot, u muar plaçkat dhe ju vunë zjarë, si doqnë Tepelenën u zgjatnë më poshtë, dhe doqnë këto fshatëra. Bençe, Velgjot, Turan, Dukaj, Memalias, dhe Zaljari. Këtu qindruan.



MASAKRAT E HORMOVITEVE

Thamë që Hormovitë i shpunë në Kodrë. Si qindruan trupat e Gjinokastrës në Zalari, Kolloneli Zira u këthye në Kodrë ku kish lënë Hormovitë dhe vendosi tu japë funt jetës Hormovitëve. I ndau Hormovitit me tri banda nga 60 shpirt të lidhur kra me kra dhe i vuri me tre vënde, pastaj zgjodhi nga trup i ti 36 veta nga më të zotët në bajonetë dhe i urdhëroj tu vinin bajonetat dyfekëve. Si i vunë ba-

jonetat ju tha që të ndaheshin më tri banda nga 12 shpirt, dhe të vinin në vëndi ku qenë Hormovitë dhe ti ç'ponin me bajoneta. Andarët bënë pas urdhërit që ju dha Kumandari. Vanë ku qenë Hormovitë dhe zunë me radhë ti ç'ponin me bajoneta! . . . të mjerët Hormovitë të lidhur këmb'e duar po çponeshin pa mëshirë prej katilëve. Kjo scenë tragjike u bë mun në Kishë të fshatit si i mbaruan të gjithë së ç'puari i hodhë me një përhua të fshatit. Ky qe fundi tragjik i Hormovitëve.

ARMISTICA

Më 12 të Mait u bë një armisticë midis Shqipëtarëve edhe andarëve. Shkaku i kësaj armisticë qe se dotë mbahej një Konferencë në Korfus prej Konsujve fuqive mbëdha dhe prej Delegatëve që do të dërgonin nga an'e guvernës Shqipëtare dhe nga Zografua. Ollandezi që gjendej në Këlcurë dërgoj në Përmet një oficer me një xhandarma në Kumandari Grek Mavroidhi dhe u muar vesh që të shënonin një vijë neutrale gjer sa të mbaroj Konferencën e Korfuzit. U ngrit Mavroidhiu dhe vate në Këlcurë ku u bashkua me Ollandezin dhe shënuan vijën neutrale me bajrakë të bardhë. Qeveria Shqipëtare dërgoj delegat në Korfuz Kollonelin Thomson dhe Medum Be Frashërin, nga an'e Kryengritësve vate Zografua me Dhulin. Kjo Konferencë mbajti një javë dhe përfundoj duke dhënë Zografos ca privilege për ato vise që bënë Kryengritje. Zografua futi dhe Korçën brënda po këtu gjeti kundrështim nga Medum Beu, se i tha "pse kërkoni privilege për Korçën kur Korça nuk deklaroj Kryengritje." Zografua ju përgjey "kam detyrë të mpronj të Krishter-

ët." Më së fundi u pranua dhe e Korçës. Privilegjet që i dhanë Zografos qenë këto:

1. Këtot vise që deklaruan Kryengritje ta njinin për mbret, Mbren'e Shqipërisë dhe flamur'i Shqipërisë të valontej ku do.

2. Nënë punësit dhe xhandarmaria të qenë vëndës prej të Krishterë dhe Myslimane, dhe qeverija Shqipëtare nuku kish të drejtë ti këmbentej nënë punësit, Toskët ti ithtej në Gjegëri, dhe Gjegët në Toskëri.

3. Të ardhurat e këtyre viseve pesi të paguhe-shin arxhet që do të lipseshin për këto vise të mbeturat do të dërgoheshin në arkë të përgjithëshme.

4. Gjuha zyrtare të qe Shqipja në gjykatore dhe në shkollat. Shkollat Gërgisht të mbeteshin siç qenë po të mësohej dhe Shqipja si gjyhë zyrtare.

Kishët të mbeten siç kanë qënë në gjyhën Gërgisht.

Këto privilege mori Zografua. Po posa mori funt kjo Konferencë si vëllaj i Zografos, Esati si kur e kish bërë fjalë me Zografon për të çkatëruar fare Shqipërinë. Nuku mënoj fare pas Konferances po deklaroi kryengritje kundër mbretit Shqipërisë. Kështu pra së mjerës Shqipëri ju vu zjari nga të dy anët, Grekërit kur mësuan kryengritjen e Esatit u gëzuan pa masë se ujku kur do herë kërkon mjer-gull. Këtë herë pra Grekërit i dhanë funt Shqipërisë si kundër dhe Esati andej.

Plasi Kryengritje në Korçë, që u vranë njeri jatërin në për rugat e Korçës dy herë u dërgua Mandatar nga mitropolia e Permetit në Korçë Pano Litua, vate dhe ardhi pa kupëtuar qeveria Shqipëtare. Tani andarët po përgatiteshin tu bënë tjetër offe-sivë Shqipëtarëve.

OFFENSIVA KUNDËR KËLSYRËS DHE TË CHEPANIT

Bëneshin përgatitje kundër këtyre viseve. Unë ndodhesha në Dhiavat të Sevranit një ditë kisha dalë me nja dy shokë të mi dhe po shikonim fshatërat e djegura dhe po qanim allet që si do të vintej puna jonë. Zbritmë më një fshat të djegur që quhej Seniçan në këtë fshat pamë që me të dalë të fshatit kish mbetur vetëm një shtëpi e pa djegur, ju dreqtuam kësaj shtëpie. Kuxuam dhe rymë brëndë. Ku shikojmë me një çip të dhomës po rintej një plakë në vërsë jo më poshtë se 60 vjet, plaka posa që na pa u tremp po neve ju afruam dhe e pyetmë që ç'bën, ajo posa që digjoj Shqip u gëzua dhe na tha Shqipëtatrë ini or bir? po ju përgjeqmë. Po ç'bën plakë? si të mos të jem or bir, ç'janë këto gjynaë vallë që të ronj unë dhe të shikonj gjithë këto të këqija! durim plakë se janë të gjithë të shkruara që do ti pësonim këto. Këtu e mjera plakë zuri qahu dhe me zë të mallengjyer na thotë ç'durim më thoni? to tu a di për mirësi të madhe sikur të më jepnit një plump të vdes, të shpëtonj se s'durokam dot. Unë plakë sot me lehra të bardha të më bënet ajo që s'e kam bërë në të rit'emi të gjitha i durova, djalin vëllanë mi vranë po kjo nuku pati anë të ç'nderohem unë plakë sot. Po kush të ardhi moj plakë? i thamë po ku di unë or bir ca Gërqishtarë më vinë për dita për të dëfryer me mua plakë!

Këtu na u mbushnë sytë me lot. Tek po rinim të mallëngjyer një erë e ligë na ardhi nga dhoma tjetër. Pyetmë plakën pse vjen kjo erë e ligë. Ch'apni në dhomë tjetër të shikoni or bir na thotë plaka duke psherëtitur, rymë në dhomë tjetër, po ç' të

shikojmë? Shtritur në mes të dhomës një nuse e bukur si Djelli, e vdekur! e mjera dukej që qe dhe me barë, dhe nga që kish shumë dit, kish zënë të mbantej erë. Ahere vemi në plaka dhe e pyesim që ç'është kjo nuse e vdekur në dhomë. Plaka na thotë duke qarë që është nus'e djalit 10 muaj martuar. Po kush e vrau e pyetmë? Nuku di seç i bënë or bir, atë ditë qe na doqnë fshatin andarët ma zunë nusen nja dhjetë shpirt e mbyllë në odë! pas nja dy orë shkuan. Kur vete unë e zeza në dhomë gjenj nusen të vdekur në mes të odës!.....Ahere kërkuam në shtëpi një kasmë të cilën e gjetmë dhe vamë jashtë në kopshtë hapmë një gropë, pastaj e muarmë të mjerën nuse e mpshuallmë me një robë dhe e vunë në atë gropë që hapmë. Pastaj plakës i lamë ca bukë që kishim me vehte dhe shkuam, fatin e së cilës nuk'e dimë seç u bë.

Siç thamë më sipër që andarët po bënëin pregatitje për të bërë ofensivë kundër Këlsyrës ,dhe Chepanit, shënuan ditën e cila qe e hëna 29 Maj. Pllan'i offensivës u bë kësisoj: Fjorgakaqi, Jorgollaqi, Qiro Vaso, në Miçan t'i binin Backes. Kapedan Farmaqi në Malint t'i Bintej Koprënckës, Sotir Bubuna në sëvran t'i Bintetj Qafës Rogut, Kapëdan Niko, Aristidhi, dhe trup' i Kocifaqit në qarishtë Kundreq Muzhakës. Kapedan Psaroj, Papa Jani, Kepedar Zerva, Kapedan Kollovoj, trup' i Karaxhaqjt, në Fratar, Mavrovoidhi në Breshan me gjith top. Offensiva zuri më 2 ora në mengjes në Qarishtë. Dyfeku u ndes në të tërë vijën, topi nga Brezhani po bombardhonte pa pushim Këlsyrën, topi tjetër nga Miçani po bombardhonte Backën, trupat' e Qaristesh u sulë kundër pozitave që kishin Shqipëtarët. Mëngjezi edhe nuku kish përhapur erësirën e na-

tës. Këtu u trazuan andarë dhe Shqipëtarë bashkë pylli që i dëntur, erëcira e thelë,, dhe kështu nuku mereshin vesh njeri tjetër, si u zbardhëlye pak Shqipëtarët u mblodhë dhe iknë dhe andarët ju ranë pas në Qarisht u vranë 4 andarë dhe 4 uplagosnë. Si u thyhen Shqipëtarët e Qarishtes, u thyhen dhe të Këlsyrës, u thyhen dhe të Backës, rynë në Backë zjarë, Chorovodës zjarë. Trup'i i Sevranit ryri në Rrog zjarë, në Muzhake zjarë, në Chepan zjarë. Trup'i Qarishtes ryri në Pristë zjarë. Trupat'e Këlsyrës rynë në Topojan zjarë, në Bedaqas zjarë, në Zhepovë zjarë, në Kajcë zjarë, në Toskësh, zjarë, në Vinokash zjarë, në Ballabanas zjarë, në Bubez zjarë, në Mazhan zjarë. Trupat e Gjinokastres i rynë Dragotit zjarë, Beçishtit zjarë, Meçgoranit zjarë, këtu qindruan.

Plaçkat që zunë andarrët në këto fshatëra nuku kanë hesap si edhe gjë të gjallë. 300 barrë vetëm bakërë vanë në Janinë, gjë e gjallë me mijëra krerë po shkonin për në Greqi. Në Backë u therë 30 shpirt gra dhe foshnja që nuk haritnë të shkonin në Zhepovë 15 gra me djepe në krahë i zunë i therë me gjithë foshnjat që kishin. Shqipëtarët u demoralizuan se nga njera anë përparimet e andarrëve; dhe nga tjetra anë përparimet e Esatit i cili zuri Beratin, kështu pra Shqipëtarët duke gjendur në mes të dy zjarëve u përndanë dhe nuku munt të mbanin më zinxhir. Muhamedanët Shqipëtarë që shkuan me gjithë fëmije për në Berat, hoqnë të zit e ullirit, s'kishin vënt se ku të gulnin fëmijën dhe nga ana tjetër ushtëri i Esatit po i mundonte nga këto shkake vendosnë me të shumët të këtheneshin në për gërmadhat e tyre që u bënë andarët. Vendosnë tu faleshin prapë atyre që i përvëluan, që i

therë, që i ç'nderuan. Kështu pra u këthyen shumë fëmije. Përmbi 300 fëmije ardhë në Vinokash, Toskësh, Kajcë, dhe Zhepovë. Përmbi 400 fëmijë ardhë në Skrapar. Po të zezta këta seç hoqnë nga andarët se me njanë u dhanë fjalën që do mos pësonin gjisendi dhe nga tjatëra anë u punuan ata më të ligat.

Një Grek i quajtur Koqino nga Lefkadha e Greqisë me 3 shokë të tjerë u nis nga Chepani dhe vate në fshatin Rovicë, pasi hëngr'e pinë zunë burrat e fshatit dhe i lidhë u pëlqyen nja dy mushka që kishin u a muar. Pëlqyen dhe një çupë e muar dhe atë dhe u nisnë për në Chepan. Kur u afruan afër Chepanit dënjë pak të çlodheshin, këtu vendosnë ti lëshonin burrat që kishin marë, se me qënë që qënë afër Chepanit nuku kishin no një frikë se mos u bënin gjisendi burrat e fshatit. Kështu pra burrat i lëshuan. Burrat si u lëshuan nuku vanë në fshat të tyre, po vanë me një fshat tjetër që qe atje afër dhe ju a bënë të njohur këtë që ngjau. Burrat e ati fshati nuku mënuan po mori si cili atë armë që kish dhe duall tu azinin këtyre bukuroshëve me një përhuaku do shkonin me do e mos. Andarët si dëfryen me atë të mjerë çupë që kishin marë u nisnë për të shkuar kur aritnë në vëndi që u a kishin zënë u ardhë plumbat si breshër. Njeri nga ata u plagos dhe ariti të futej në pull të dy të tjerët zunë nga një gur dhe po lëftonin. Myslymanët si panë që nuku munt ti vrisnin dot se kishin zënë vënt të fortë nja dy prej ta u erdhë rotull dhe u zunë krahët dhe se andejmi ju dhanë nga një plump dhe i lanë në vënt. Pastaj u afruan u muar armët, mushkat, çupën e mjerë dhe shkuan në fshat të tyre. Në fshatin Rog qe Rakipi me gjithë fëmijë. Rakipi kish një çupë 12

vjet. Një ditë i vanë ca andarë për të dëfryer me çupën e vogël. I mjeri Rakip vuri ulërimat. Andarët zunë therë Rakipin edhe fëmijen etij!.....

Ika nga trupi që qe në Chepan dhe u hodha më një trup tjetër nënë kumandën e një oficeri Grek i quajtur Nikollopulos. Ky oficer qe një shumë burr'i mirë se nuku qe Grek që nga viset e Shqipërisë, nga Himara. Zura një miqësi të ngushtë me këtë oficer i cili më vuri përkujdestar i amjeve të ati trupi. Ky trup rintej në Përmet pas ca dit kumandar'i përgjithëshme vendosi këtë trup ta hedhë në Toskësh. Pas urdhërit u ngrit më nga Përmeti dhe u nismë për në Toskësh. Vamë në Toskësh ku gjemë një shtëpi në funt të fshatit më një brek e cila për fat kish mbetur e pa djegur. Në këtë shtëpi qindruam që të rinim, ushtarët e këti trupi u vendosnë në bregu i Vinokoshit. Në këtë vijë qenë dhe 3 trupa të tjerë. Trup'i Kollovojt, trup'i Fjogollaqit dhe trup'i Zervës të tre këta trupa qenë vendosur në qafë të vendreshit. në këto fshatëra ardhë të faleshin po thua 200 fëmije të cilët sual dhe ç'mall u kish mbetur. Kishin dhe 600 krere bageti. Kumandarët e këtyre trupave ju zotuan këtyre fatzinjve që do mos pësonin gjisendi. Ardhë të mjerët dhe bënë nga një Kosallë për të ngulur fëmijen e tyre.

Nuku shkuan shumë dit pas faljes e këtyre fëmijëve. Andarët e këtyre trupave zun ti besdisin fëmijen e falur u vinin në për Kasollet e tyre dhe donin ti ç'nderonin. Gratë te mjera vinin për dita dhe qjaheshin, nga ky shkak ju luta oficerit tim që ti mbronjë fëmijen e mjerë. U fjalosa me të dhe ju luta që ta mertej zyrtarisht nga Kumandar i përgjithëshëm mbrojtjen e fëmieve, prandaj u ngrit dhe

vate në Përmet që ta mertej zyrtarisht. Bashkë me të vajta dhe unë. Në trupin tonë qe një Grek Manjat i quajtur Arnaut. Ky bukurosh me rastjen e ikjes tonë në Përmet, vate në shtëpi të Ametit nga Vinokeshi hyri brënda gjoja për të kërkuar armë, ku nuku gjeti gjisendi, gjeti vetëm më një stre në një kobure me çark të prishur me shkakun e kësaj kobure Greku e lidhi Ametin. Ameti kish një kalë të mirë të cilën ja mori, mori dhe Ametin dhe shkoj, vate dhe me ca shtëpira të tjera zuri dhe dy të tjerë për shkak se kishin armë, si i lidhi mirë këta të tre u a dha 3 andarëve dhe ju tha që ti nzirnin jashtë fshatit dhe ti vrisnin. Andarët i muar dhe i shpunë gjer në Ballabanas dhe atje ju dhanë nga një plumb dhe i lanë në vënt.

Oficeri tim me të vatur në Përmet vate në gjykatore dhe ja bëri të njohur qeveritarit Grek i cili qe Z. Manduvallo, dhe ikërkoj që ti a jeptej me të shkruar mbrojtjen e fëmijëve i cili ja dha, si mori të shkruarën u nismë për në Toskësh. Kur haritmë në ballabanas gjetmë të tre Myslymanët në mes të hudhës të vrrarë. Kur vamë në shtëpi pyetmë për ata të vrrarët me këto fjalë vjen e hema e Ametit duke qarë dhe na lutet për të birë që ta lëshojmë se nuku e dintej e mjera që Ameti qe shtrirë në mes të hudhës. Oficeri më thotë që ç'kërkon, dhe unë i thashë që është nënja e Ametit që e gjetmë të vrrarë. Oficerit i ardhi shumë liksht dhe më thotë që thuaj të shkonjë se djalin për ca dit do ta lëshojmë, e mjera nënjë shkoj. Më këto e sipër Arnauti mori kalin dhe krisi në Përmet dhe su këthye më në Toskësh. Ca andarë të trupit Zervës vanë në fshatin Vendresh dhe zunë 7 burra dhe një djalë, shkakun i këtyre që se gjoja kishin parë Shqipëtarët të rynnin në Ven-

dresh si i lidhë këta të 8 shpirt i suall në qaf'e Vendreshit dhe atje i therë me radhë. Kur ardhi sëra e djalit, djali i pa trembur qindroj dhe tha doni or barbarë duke therur Shqipëtarët ti shuani po dhe një Shqipëtar si kur të mbetet nuku do tu lerë të qetë, rroftë Mbreti i Shqipërisë. Pa mbaruar këtë fjalë dor'e katilit i rra me thikë në zverk dhe i mjeri djalë u shtrit për dhe me fjalë rroftë mbreti!.....

Shqipëtarët të cilët qenë përndarë dhe nuku mbanin me kufi si mësuan këtë ngjarje u mblodhë të gjithë sa qenë në Vendresh dhe vendosnë që të bënin një ofensivë për të fundit herë. Qe dit e Martë më ora 12. Shqipëtarët ju sulë qafës Vendresht ku mprohej për 300 andarësh. Dyfeku zuri i reptë nga të dy anët. Shqipëtarët u sulë verbasi mbi ta sa i shtrenguan andarët të linin vëndet dhe i ndoqnë gjer në qaf e Kajcës. Dyfeku zuri më tërë vijën andarët të gjithë u thyen dhe zunë atë natë Këlcyrën. Kur mësoj Kumandar'i Përmetit ofensivën e Shqipëtarëve u ngrit nga Përmeti me ushtërin'e tij dhe ardhi në Këlsyrë dhe atë mbrëma vendosmë që të nesërmen tu bënin ofensivë Shqipëtarëve. Me të nesërmen shpunë të dy topat mbi Topojan dhe dhanë urdhër që të bombardhojnë qafën e Kajcës, të dy topat po bombardhonin qafën e Kajcës pa reshtur dyfeku u ndes më tërë vijën. Shqipëtarët u shtrenguan të hiqen dhe andarët' po vinin të zinin vendet që kishin më parë. Fëmija e falur kishin marrë pylet të cilët u therë e tërë fëmija prej andarëve. Këtë radhë i dhanë funt andarët Toskërisë së vanë gjer në ujët e zi dhe dogjë të gjithë fshatërat që qenë rotull, zunë 180 fëmijë në lumë të Shkraparit dhe i therë. Guverna Greke me rastin e luftës Evropianë që krisi dërgoj ushtërin e regulshme në

Ipirë që të siltej qetësinë!... Me të ardhur ushtëria e rregulshme nënë Kumandën të Z. Populla mbloshi andarët u mori armët dhe i dërgoj në për shtëpira..... Shqipëtarë! u doqme, u thermë, u ç'nderuam u shkretuam, nga ç'kak? nga mos bashkimi ynë. Fanatizma e fesë na i solli të gjitha këto mjerime. Lutem pra Zotit që këto pësime të na bëjnë mësim dhe të gjithë tok si vëllezër me një mendje me një shpirt të përpiqemi për lumtërinë e atdheut tonë. Poshtë fanatizma -e fesë. Rofshin li berallët!....

Edhe mos shikoni Kisha Zhamia

Fe e Shqipëtarit ashtë Shqipëtarënia (V. P.)

FUNT



